



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**EMËRTIMI I LIDHJEVE FAMILJARE
DHE FAREFISNORE NË TË FOLMET
SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT**

Kandidati:

Jetlira Imeri

Mentor:

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

**Tetovë,
2019**

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE.....	5
1. LËNDA E HULUMTIMIT	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	6
HIPOTEZAT	7
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
3. RËNDËSIA E PUNIMIT	9
HYRJE	10
PJESA I.....	13
TERMINOLOGJIA FAREFISNORE	13
EMRAT PËRKËDHELËS DHE THIRRJET PËR RESPEKT	14
GJYSHI	14
GJYSHJA	16
LIDHJET FAREFISNORE SIPAS GJAKUT	17
Anëtarët e një familjeje sipas vijës së sipërme:.....	17
NËNA	17
BABAI	19
Emrat përkëdhelës dhe thirrjet për respekt në emërtimin e babait.....	19
I ATI.....	21
PRINDËR.....	22
GJYSHJA	22
PLAKË E MOÇME	23
GJYSHI	23
STËRGJYSH.....	24
STËRGJYSHE	24
ANËTARËT E NJË FAMILJEJE SIPAS VIJËS SË POSHTME:.....	25
FËMIJË	25
CAULL.....	25
MXHOVI	25
I BIRI.....	26

MBESA.....	26
STËRMBESË.....	26
NIPI.....	26
STËRNIP.....	26
ANËTARË TË NJË FAMILJEJE SIPAS VIJËS ANËSORE TË GJAKUT	27
TEZJA.....	28
TEZAK.....	28
XHAXHAI	28
XHAJOJCA.....	29
HALLA	30
GJYSHI (Baba i dajës) / GJYSHJA (Nana e dajës).....	31
DAJA.....	31
DAJOJCA.....	31
ANËTARËT TË FAMILJES SIPAS MARTESËS.....	31
MIK / MIKESHË	31
BURRI.....	31
PJESA II.....	33
DALLIME GJINORE TEK EMRAT FAREFISNORE	33
MOSZËNIA NË GOJË E EMRIT	34
1. Moszënia në gojë të emrit të burrit.....	34
2. Moszënia në gojë të emrit të gruas.....	34
DJALI.....	35
VAJZA, CUCA.....	36
VJEHRRRI	36
VJEHRRRA.....	37
E REJA.....	37
NUS/E,-JA.....	38
KUNATI.....	40
KUNATA.....	41
BABGJYSHI.....	41
NANGJYSHE	41
DHËNDËR.....	42
NJERKA.....	42

NJERKU.....	43
LIDHJE FAREFISNORE ARTIFICIAL	43
Farefisni shpirtërore	43
VËLLA.....	43
VËLLAMËRI (pobratim).....	43
EMRAT E GRAVE ME EMRIN E BURRIT.....	44
ZHARGONE QË LIDHEN EMRAT FAMILJARE	44
EMRA ME PREJARDHJE TË HUAJ	45
Huazime nga turqishtja.....	45
Huazime nga latinishtja.....	45
Huazime nga sllavishtja	45
PJESA III	46
FRAZELOGJIZMA ME KOMPONENTË EMRA FAREFISNORË	46
FRAZELOGJIZMAT QË LIDHEN ME EMËRTIMET FAMILJARE.....	47
Frazeologjizmat që lidhen me familjen.....	48
SHTOJCA	52
ANKETIMI I EMRAVE FAMILJARË.....	52
FJALOR	65
PËRFUNDIME	82
INFORMATORËT	85
BIBLIOGRAFIA.....	87
PYETËSORI	91

MIRËNJOHJE

Mirënjohje për të gjithë ata që më ndihmuan ta përfundoj këtë rrugëtim që e fillova, realizimin e këtij punimi e arrita me mund por me shumë dëshirë duke u bërë pjesë e bashkëpunimit edhe shumë njerëz tjerë, i falënderoj edhe njëherë nga zemra.

Mirënjohje dhe falënderime për mentorin e tezës së masterit, prof.dr.Mustafa Ibrahim, për mbështetjen profesionale dhe akademike që më ka dhënë gjatë gjithë procesit të punimit të masterit, për përkushtimin, këshillat dhe nxitjen të cilat kanë ndikuar në realizimin dhe pasqyrimin më të mirë të tezës së masterit, por edhe në formimin tim profesional kërkimore - shkencore.

Mirënjohje të veçantë, përveç mentorit kam edhe për profesorët e mi të cilët më ndihmuan gjatë studimeve: prof.dr. Zeqir Kadriu, prof.dr. Vebi Bexheti, prof.dr. Hamit Xhaferi, Prof.dr. Luljeta Adili – Çeliku, prof. Meral Shehabi dhe prof. dr. Jehona Rushidi. U jam gjithashtu shumë mirënjohëse gjatë gjithë këtyre viteve që me punën e njohuritë e tyre, kanë bërë të mundur që mua të më trefishohet dashuria me të cilën e nisa këtë rrugë drejt dijes.

Fjalët e fundit të miat për falënderim shkojnë drejtë familjes sime të shtrenjtë, duke e falënderuar për mbështetjen , durimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe.

1. LËNDA E HULUMTIMIT

Nga aspekti etnolinguistikë, mjaft me vlerë përbën lënda që lidhet me emrat vetjakë, me emrat familjarë e farefisnorë, aq të shumtë e të larmishëm në trevat shqiptare. Kjo lëndë mjaft e pasur e emrave që emërtojnë lidhjet e farefisnisë apo edhe përgjithësisht raportet familjare ndër shqiptarë, do ta trajtojmë në aspektin e etnolinguistikës strukturale e më gjerë¹. Gjuha shqipe ka një shtrirje të gjerë të përdorimit për sa u përket emërtimeve familjare e farefisnore, të cilat paraqiten me më shumë variete dialektore a krahinore. Prej këtu, një dukuri me interes na duket se përbën në shqipen sinonimia e emrave familjarë e farefisnorë të përftuar nga trysnia shoqërore e kulturore, mbi bazën e të cilës kemi mundësi për të përsiatur e shqyrtuar edhe jo pak pikëtakime të izoglosave me **izoergjet** përkatëse.

Si lëndë e hulumtimit jam përcaktuar për **emërtimet e lidhjeve farefisnore në të folmet shqipe në Maqedoni**, duke përfshirë këtu të gjitha krahinat në Maqedoni ku jetojnë shqiptarë. Theksi i gjithë punimit është mbi këto dy targete, duke i përcjellur ato edhe me disa krahasime të emrave edhe nga hapësiat tjera mbarëshqiptare. Objekt studimi mbeten emërtimet e lidhjeve farefisnore nëpër dialekte dhe krahinat. Një analizë gjuhësore, një këndvështrim semantik dhe një zbërthim i këtyre emërtimeve mund të japin rezultate mbi shumë rrethana sociale dhe psikologjike të vendit dhe të shoqërisë ku jetojmë.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Ky hulumtim gjuhësor ka disa qëllime apo objektiva rreth të cilave do të punohet, por theksi është i vendosur mbi aspektin semantik dhe pragmatik të **emërtimit të lidhjeve familjare dhe farefisnore në të folmet shqipe në Maqedoni**. Në vendin tonë emërtimet kanë zënë vend të rëndësishëm gjatë historisë.

Përgjithësisht, këto emra kanë kuptim zbulues dhe jo të gjitha bëjnë pjesë në fondin leksikor letrar. Vështirësitë që ne hasim në terren lidhen me ndryshime në përdorimin gjinor e që i ka rrënjët më të thella në vetë mënyrën e jetesës së shqiptarëve. Vëmendja përqendrohet në disa emërtime më të lashta dhe forma të të folmeve, që ndryshojnë përdorimin. Është fjala për disa nga emërtimet e sferës familjare e të respektit, që krijohen e sillen brenda një

¹ Shih: Shefki Sejdiu, *Probleme të etnolinguistikës strukturale: raportet e farefisnisë dhe sistemi nomenkultural i saj te shqiptarët*, në "Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990, f. 52-65 dhe *Toleranca normative në sistemin nomenkatural të farefisnisë në shqipen standarde*, në "Filologji", 5, f. 47-51.

shoqërie. Në mënyrë të veçantë kundrime të tilla gjejmë në disa nga të folmet e krahinave a viseve më anësore dhe përgjithësisht ruajtëse (konservative), siç janë ato të Malësisë së Madhe në anët e Veriperëndimit, të Labërisë fshatare e të Çamërisë në Jug si dhe të folmet e diasporës arbëreshe në Itali, Greqi etj., por ne do të përqëndrohemi më tepër në vendbanimet shqiptare të Maqedonisë.

HIPOTEZAT

Më poshtë kam formuluar dhe paraqitur disa hipoteza rreth të cilave do të trajtohet ky punim hulumtues, duke u mbështetur në një hipotezë bazë dhe dy hipoteza ndihmëse:

- **Emërtimi i lidhjeve farefisnore në të folmet shqipe në Maqedoni** në përgjithësi, por më konkretisht në Maqedoni shprehin identitetin dhe mënyrën e komunikimit midis anëtarëve të familjeve ; kuptimi i tyre reflekton mbi strategjitë dhe skemat konceptuale politike;
- Mesazhet që mbartin emërtimet farefisnore kanë një forcë të jashtëzakonshme në bindjen e popullit dhe në marrjen e vendimeve sa i përket funksionimit të një familje . Pra, emërtimet nuk janë thjesht fjali të shkurtëra vendosur mbi emrin e vërtetë të familjes, ato kanë një forcë tërheqëse në prestigjin e një familje;
- Emërtimet e lidhjeve farefisnore nuk pësojnë ndryshime të mëdha nga viti në vit; por dukshëm mund të vërehet se harrohen ose nuk përdoren më nga brezat e rinj.
- Në ato emërtime, sigurisht, ka edhe një sasi prej tyre që vijojnë nga gjuhët e moçme me të cilat shqipja ka qenë në marrëdhënie të hershme e të vazhdueshme, si nga latinishtja dhe nga greqishtja e vjetër, por ka edhe emërtime të reja, të mëvonshme, të cilat, nga ana e tyre, tregojnë e dëshmojnë bindshëm lidhjet e qarta me mendësi kulturore të krahinave përkatëse apo edhe më gjerë: të trevave shqiptare në përgjithësi

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës
2. Strukturimi i materialit teorik
3. Formulimi i tabelave të emërtimeve familjare dhe farefisnore, formulimi i pyetësorëve për familjet

Faza e mbledhjes së të dhënave

1. Kërkime për mbledhjen e emërtimeve familjare dhe farefisnore
2. Lexime të teksteve të ndryshme për gjetjen e emërtimeve familjare dhe farefisnore
3. Intervistimet me personat kompetent për çështjen e ngritur
4. Klasifikimi i të dhënave

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Kategorizimi i emërtimeve familjare dhe farefisnore në bazë të kohës së përdorur, në bazë të vendit të përdorur dhe strukturës
2. Analiza semantike dhe pragmatike e materialit të mbledhur, pa lënë anash edhe një analizë nga këndvështrimi stilistik
3. Shqyrtim dhe zberthim i përgjigjeve të mbledhura nga intervistimi i banorëve të Maqedonisë, po ashtu shqyrtim dhe konkludim rreth përgjigjeve të dhëna nga psikologët e vendit mbi emërtimet familjare dhe farefisnore
4. Përgjithësime dhe konkludime

Metodologjia e kërkimit

Ky punim hulumtues u mbështet në disa metoda kërkuese për të analizuar e për të ardhur në rezultatet e caktuara. Metodologjia e kërkimit u bazua në metodën e analizës së materialit të mbledhur poashtu metoda e sintezës, në bashkëveprim me metodën krahasuese, metodën e intervistës dhe anketës. Të gjitha këto metoda në bashkëpunim me njëra tjetrën ndihmuan në fitimin e rezultateve të hulumtimit. Njohja e bazave teorike dhe materialit të mbledhur u analizuan me metodat e lartpërmendura duke u vënë në dy rrafshë apo dy drejtime hulumtuese:

1. *Mbledhja e materialit të targetuar me anë të metodës së eksplorimit dhe të intervistave*
2. *Analiza e materialit të mbledhur me anë të metodës së analizës dhe sintezës, poashtu dhe metodës komperative*

3. RËNDËSIA E PUNIMIT

Të përzgjedhish një temë hulumtimi duhet të kesh parasysh pikë së pari rëndësinë e atij punimi. Cfarë risi do të sjell ky punim në atë fushë?- Cila është rëndësia e tij? A do të hap diskutime dhe hapsira të reja për tu punuar në atë temë?- Të gjitha këto pyetje duhet parashtruar para se të zgjidhet një temë punimi. Njohja e rëndësisë së hulumtimit është një hap i madh drejt përpunimit dhe përfundimit të temës së caktuar. Edhe ky punim përmban në vete një rëndësi të madhe në fushën e linguistikës dhe sociologjisë, por njëkohësisht një rëndësi dhe një kontribut mund të japë në fushën e etnolinguistikës dhe sociolinguistikës.

Gjuha si mjet kryesor komunikimi ka një rëndësi të madhe në çdo fushë ku aplikohet. Edhe në fushën e politikës gjuha luan një rol të pazëvendësueshëm, sistemi i saj kompleks lejon të bëhen analiza të ndryshme gjuhësore me anë të cilave mund të kuptojmë strukturat ndërtuese, funksionet dhe rëndësinë e gjuhës. Stilet e gjuhës ndryshojnë sipas përdorimit dhe vendit të përdorimit, një vështrim stilistik mbi këtë çështje mund të japë përfundime të cilat japin një kontribut në fushën e komunikimit. Po përmend komunikimin në prgjithësi si fushë e gjerë ku gjuha luan një rol të rëndësishëm, për të shprehur marrëdhënien e gjuhës me shoqërinë dhe për të treguar rëndësinë që ajo ka. Por meqë ky punim ndalet të trajtoj vetëm komunikimin prestigjioz të emërimit të familjeve dhe farefisit, po përmendim edhe rëndësinë e njohjes dhe analizës së emërtimeve të tyre.

Një nga anët më interesante të përdorimit të emrave të farefisnisë në trevat shqiptare, është edhe mundësia e tyre e gjerë për t'u përdorur edhe me funksione politese apo si respektforma. Çdo pjesëtar të familjes që është më i madh se anëtarët tjerë të familjes emërtohej me një fjalë përkëdhelëse, duke mos ia zënë emrin e tij në gojë.

HYRJE

Nga aspekti etnolinguistikë, mjaft me vlerë përbën lënda që lidhet me emrat vetjakë, me emrat familjarë e farefisnorë, aq të shumtë e të larmishëm në trevat shqiptare. Sinonimia e emrave familjarë dhe të farefisnisë është një dukuri që paraqet shumë interes dhe që është e lidhur me shtresat kulturore, shoqërore e krahinore, njohja dhe shqyrtimi i të cilave shpie në pikëtakime interesante mes mënyrës së të menduarit dhe mënyrës së emërimit të shumë fjalëve në zona a treva të ndryshme. Vetë dukuria është jo fort e rrahur nëpër studimet shqiptare deri më tash, çka vetiu jep dorë për sprovë dhe shqyrtim të saj në gjendjen e sotme, jo vetëm në një rreth të ngushtë.

Kjo lëndë mjaft e pasur e emrave që emërtojnë lidhjet e farefisnisë apo edhe përgjithësisht raportet familjare ndër shqiptarë, do ta trajtojmë në aspektin e etnolinguistikës strukturale e më gjerë. Studiuesit që janë marrë me këtë problem, pohojnë se kjo është një ndër fushat më specifike, interesante e njëherësh më e lakmueshme për t'u ndjekur e trajtuar, pasi virgjiniteti i saj nuk lë vend për diskutim. Gjuha shqipe ka një shtrirje të gjerë të përdorimit për sa u përket emërtimeve familjare e farefisnore, të cilat paraqiten me më shumë variete dialektore a krahinore. Prej këtu, një dukuri me interes na duket se përbën në shqipen sinonimia e emrave familjarë e farefisnorë të përfutur nga trysnia shoqërore e kulturore, mbi bazën e të cilës kemi mundësi për të përsiatuar e shqyrtuar edhe jo pak pikëtakime të izoglosave me izoerget përkatëse. Në mënyrë të veçantë kundrime të tilla gjejmë në disa nga të folmet e krahinave a viseve më anësore dhe përgjithësisht ruajtëse (konservative), siç janë ato të Malësisë së Madhe në anët e Veriperëndimit, të Labërisë fshatare e të Çamërisë në Jug si dhe të folmet e diasporës arbëreshe në Itali, Greqi etj., (Ibrahimi 2012:229).

Këto emra kanë kuptim zbutues dhe jo të gjitha bëjnë pjesë në fondin leksikor letrar. Është fjala për disa nga emërtimet e sferës familjare e të respektit, që krijohen e sillen brenda një shoqërie. Në mënyrë të veçantë kundrime të tilla gjejmë në disa nga të folmet e krahinave a viseve më anësore dhe përgjithësisht ruajtëse (konservative), siç janë ato të Malësisë së Madhe në anët e Veriperëndimit, të Labërisë fshatare e të Çamërisë në Jug si dhe të folmet e diasporës arbëreshe në Itali, Greqi etj. (Sejdiu 1990, f. 52-65). Folësit në fjalorin e tyre popullor të Kosovës, krahas nofkave keqësuese, përdorin dhe fjalë e shprehje që shënjojnë respekt si për burrat, edhe për gratë: *Agë, Abej, Babalok, Bac, Lalë, Inxhe, Loke, Nanloke, Loçkë*, etj. E, për shkak të përdorimit të dendur të fjalës *Loçkë* (me kuptimin xhan), shqiptarët e Maqedonisë i quajnë ata të Kosovës me nofkën *Loçkat* (Murati telegrafi 19.07.2019),

Emërtimi i farefisnisë në të folmen e vendbanimeve shqiptare të Maqedonisë (Ibrahimi 2012: 232-236) si dhe punimeve seminarike të studentëve, si dhe hulumtimeve të mia në terren.

Profesor Ibrahimi ka bërë edhe një studim interesant për emrat e farefisnisë në vendbanimin arbënesh të Zarës, siç janë: didi (gjyshi), diveri (kunati), gjeverusha (kunata), lala (xhaxhai dhe daja), oçui (njerku), soçi/shoçi (burri), soçe/shoçe (grua), strina (grua e xhaxhait); kushria (fqinji), kadna (zonjë), gjuvegi (të fejuar), rogjaki (farefisi), vajzica (vajzë e vogël), vajznia, s'ame, çeGjuros (grua e Gjurës), çeMates (grua e Mates) (Ibrahimi 2018:12-13). Kurse në disa të folme, si në atë të Prilepit, Matit etj., për fjalët shqipe standard: *vjehërr*, *vjehërra* kemi sinonimet; baba i nuses, nana e nuses, krushku, krushka, meku, meku i shpais, e ama e nuses, ndërsa sa i përket farefisit të nuses quhen „prent“ (Mat) “ d’vet” (Prilep) dmth. familja e prindërve të

Studiuesi Sh. Sejdiu pohon: “*Pikërisht për të shmangur a mënjeluar homoniminë dhe ngatërrimin, ndër shqiptarë, janë ndërtuar struktura nomenklaturale sinonimike, që janë të karakterit „s qarues“ dhe që përdoren më tepër në komunikimin indirekt me të tjerët: kushëri; djalë axhe, nip: djalë djali (çike, motre, halle); gjysh: baba i babës (i nënës) etj*”. (Sejdiu 415). Kurse, prof. Gj. Shkurtaji i shton edhe: “Ky konstatim i bërë është i vërtetë, porse duhet veçuar medoemos se dukuria gjuhësore e sinonimisë, plekset me një trysni jashtëgjuhësore, që përkon me izoerge të caktuara sipas krahinave, shtresave shoqërore e kulturore të ndryshme. Pra, del e nevojshme që në lëndën sinonimike të bëhen edhe shqyrtime, shtresëzime e tërthorime socio-etnolinguistike” (Shkurtaji : 416).

Në të folmet e ndryshme dialektore shqipe, mjaft me vlerë përbën lënda që lidhet me emrat vetjakë, me emrat familjarë e farefisnorë, që paraqitet shumë të larmishëm Kjo lëndë mjaft e pasur e emrave që emërtojnë lidhjet e farefisnisë apo edhe përgjithësisht raportet familjare ndër shqiptarë, do ta trajtojmë në aspektin e etnolinguistikës strukturale e më gjerë. Lëndë sinonimike bëhen edhe shqyrtime sociolinguistike e etnolinguistike.

Emrat e përgjithshëm sipas pozitës që kanë pasur në familje. Në kohën e matriarkatit, nëna ka qenë shtylla e vetme që i ka ushqyer, ruajtur, edukuar dhe mbrojtur fëmijët e vegjël. Në këtë kohë nëna e ka pasur emrin NËNË dhe pjella e lindur është quajtur LIREK. Ndërsa, fëmijët sipas gjinisë janë quajtur, femra - BIJ dhe mashkulli - BIR. Në kohën kur bëhet martesë në çift, atëherë kompletohet familja në kuptim të ngushtë dhe, krahas emrit nënë, kemi edhe emrin ATË, prej nga vazhdojnë të përdorin emrat bij dhe bir, por normalisht i kanë përdorur edhe emrat e përveçëm për djem e vajza, për t’i dalluar fëmijët në mes tyre.

Krahas këtyre pesë emrave të përgjithshëm, në familje formohen edhe emra të tjerë, siç janë: lirek, fëmijë, vajzë e djalë, grua e burrë, gjyshe e gjysh, mbesë e nip, dadë e date, teze e dajë, nuse e dhëndër etj.

Shenjat semantike

Kuptimi i një termi në sistemin e termave farefisnore varet nga kombinimi i disa shenjave semantike. Në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhët tjera ballkanike ekzistojnë katër shenja dalluese semantike me të cilët dallohen lidhjet farefisnore:

1. **Shenja e brezave** - e përcakton farefisninë sipas përkatësisë së brezave të ndryshëm (*babë : bir*).
2. **Shenja e lateralitetit** - e përcakton farefisninë sipas vijës së drejtë dhe të tërthortë (*nënë : teze*)
3. **Shenjë e gjinisë** - e përcakton farefisninë sipas përkatësisë së gjinisë mashkullore dhe femërore (*vëlla : motër*)
4. **Shenjë e drejtimit të farefisnisë** - tregon se nëpërmjet cilit anëtarë të familjes realizohet farefisnia, para së gjithash nga ana femërore apo mashkullore. (*xhaxha : dajë*)

PJESA I

TERMINOLOGJIA FAREFISNORE

EMRAT PËRKËDHELËS DHE THIRRJET PËR RESPEKT

Një nga anët më interesante të përdorimit të emrave të farefisnisë në trevat shqiptare, është edhe mundësia e tyre e gjerë për t'u përdorur edhe me funksione politese apo si respektforma. Çdo pjesëtar të familjes që është më i madh se anëtarët tjerë të familjes emërtohej me një fjalë përkëdhelëse, duke mos ia zënë emrin e tij në gojë.

GJYSHI

(I ati i babait ose i nënës. Gjyshi nga babai ose nga nëna).

Edhe më e fortë dhe më e dukshme është kjo mendësi oborrësie e zburimi në rastin e emërtimeve për gjyshin e për gjyshen, ku ndeshim një deltë të gjerë emërtimeve të përbëra a të përngjitura. Me emrin gjysh mbesat dhe nipërit kanë quajtur atin e të atit dhe të atin e mëmës. Për gjeneratat para gjyshes dhe para gjyshit janë quajtur stërgjyshet ose stërgjyshërit.

Emri gjyshe është formuar shumë kohë para emrit gjysh. Emri gjyshe si fjalë është formuar nga emri i gjirit si pjesë e futur e gjoksit apo mesi i kraharorit, domethënë mesi i dy gjinjve të gruas. Gjoksi në mesin e gjinjve, ku gjendet edhe zemra, është pjesë e trupit ku nënat dhe gjyshet fëmijët dhe krejt pjellën e tyre e kanë për zemër, d.m.th. i duan për shpirti. Nga dashuria e përzemërt ndaj gjeneratës së re, formohet fjala njerëzit e gjinjve, nga e cila formohet emri gjintë ose gjinia, me të cilin emërohet një grup i vogël ose grup më i madh banorësh nga formohet edhe një popull i një gjaku. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017)

Në të folmet konservative e sidomos në diasporën arbëreshe të Italisë, ndeshim këto respektforma për gjyshin: *tatëmadhi* (< tata i madh), *tatëjashtë-i* / *tatëlashë-i* (< tata i lashtë), *Ijalbukur-i* (<ljala i bukur), që. Në të gjitha këto emërtime, siç mund të shihet, kemi të bëjmë me një izoerge Nga trevat e tjera shqiptare emërtime të tjera që duhen përfshirë në të njëjtën izoerge janë edhe : *tatëlosh-i*, *babëlosh-i* dhe format e shkurtuara *losh-i* / *josh-i* "gjysh", *babëlok-u* *babamadh-i*, *babaplak-u*, *babazot-i*, *babagjysh-i*.

Në të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë ndeshim këto emërtime: *ago*, *aga*, *ata*, *atush*, *baba bamadh*, *babuç*, *babuçka*, *babush*, *babo*, *babaplak*, *xhula*. *Haxhibaba* dhe *axhibaba* – është quajtur babai që ka shkuar në haxh.

Fjalët sinonimike në emërtimin e gjyshit dhe gjyshes

Edhe më e fortë dhe më e dukshme është në rastin e emërtimeve për gjyshin e për gjyshen, si: *tatëmadhi* (< tata i madh), *mëmëmadhe-ja* (mëma e madhe), *nanmadhe-ja* (< nana e madhe), *nenamadhe* "gjyshe, nëna e babait" (Anamal) dhe *kadna:n-a* në anët e Krajës

(besojmë nga kadëna "zonjë " + nanë), tatëlashtë-i / tatëlashë-i (< tata i lashtë), mëmëlashë-a (< mëmë e lashtë), ljalbukur-i (<ljala i bukur), që ndeshim në të folme konservative e sidomos në diasporën arbëreshe të Italisë. Me interes janë këtu edhe disa respektforma të formuara me fjalët hanko, vjehërr + mbiemrin e bardhë: hankobardha, vjehërrbardha, si dhe nusebardha, që na dalin në të folmen e Ulqinit e gjetkë.

Fjalët sinonimike në emërtimin e gjyshit dhe gjyshe

Nga trevat e tjera shqiptare emërtime të tjera që duhen përfshirë në të njëjtën izoerge janë edhe : tatëlosh-i, babëlosh-i dhe format e shkurtuara losh-i /josh-i "gjysh", babëlok-u, babëloke-ja "gjyshe" e nanloke-ja dhe forma e shkurtuar loke-ja, babamadh-i, babaplak-u, nanaplaka babazot-i, babagjysh-i, nanagjyshe-ja. Si dhe nana pla:k; bëba plak (Prilep-Krushevë)

Këtu u takon të përfshihen edhe emërtimeve që vijnë nga përngjitja e një togu përcaktues: mëmatacë-a (mëma e tatës) në diasporën arbëreshe të Italisë, nanbabe-ja (<nana e babës), nandaje-a (<nana e dajës), babdaj-a (<baba i dajës) në gegërishten veriperëndimore, *babadajës* dhe *nënadajës* (Prilep dhe Krushevë) dajgjysh-i "babai i nënës për mbesat e nipat" (Anamal) etj., motërtatë (motra e tatës) në të folmet e arbëreshëve të Italisë etj.

Përdorimi i emrave të farefisnisë me funksione politese apo si respektforma

Një anë interesante e përdorimit të emrave të farefisnisë në trevat shqiptare është edhe mundësia e tyre e gjerë për t'u përdorur edhe me funksione politese apo si respektforma.

Përdorimi i emrave të farefisnisë me funksione politese apo si respektforma

Në anët e Shqipërisë së Mesme si dhe më poshtë deri në anët e Myzeqesë, me këtë vlerë përdoret fjala lalë: ja ke lala; thuj lalës si e ke emnin; mso mirë, njashtu tëkeqen tate lala; lake moj pupulake e lales, je goc e Tiranës; hidhe moj hidhe vallen, e los lala dajren.

Përdorimi i emrave të farefisnisë me funksione politese apo si respektforma

Në qytetin e Gjirokastrës e në rrethinat e tij ka përdorim të gjerë fjala anë-ja" grua e moshuar, gjyshe e moçme", me origjinë nga greqishtja: Ku vete kaq herët moj ane? Anetë gjirokastrite dolën në dritare për të parë.

Në qytetin e Vlorës e në rrethinat e tij, shpesh, si respektformë e tillë përdoret fjala xhixhe / xhexhe: Qysh jeni, xhixhëja qysh është! T'u bëftë xhexheja, o derman! Jo rrallë përdoret edhe dede: Shko përpara ti dede. Kur rronte dedeja, e ndjera.

Në Prilep: ane-ja por edhe anko

Në Shqipërinë Veriore kanë qenë shumë të përdorshme edhe fjalët *bac-i / ba:c-a*, për meshkujt në moshë mesatare, dhe *da:d-a* për femrat e rritura. Në radhë të parë, fjalët *bac, ba:c* dhe *da:d* përdoren brenda marrëdhënieve familjare e fisnore: *bac-i* apo *ba:c-a* thërri tej vëllai i madh nga më të vegjlit në shenjë respekti e zbulimi: Shko shpejt se po erret nat, t past *baci* \ Nuk mun e la shpin vetëm pa dvet *bacin*. Moszënia në gojë e emrit

Në Malësi dhe në trevat qendrore të Shqipërisë, burri dhe gruaja nuk e zinin në gojë emrin e njërit-tjetrit, por i zëvendësonin ata me përemrat: *ti, ai, ajo, ai nieri, ajo gruaja, rahmetliu, ky, kjo* etj.

Në Dibër thuhet se "gruaja vitin e parë të martesës i thotë burrit *ki (ky)*, pasi kalojnë dy vjet e thërret *ai*, ndërsa në pleqëri e thërret stërgjish (*stërgjysh*)". Kështu edhe në Kelmend, fjala *gjyshe*, kemi dëgjuar të përdoret nga burrat për të mos thirrur me emër bashkëshorten: *a tieve, o gjyshe (a dëgjove, oj gjyshe = o ime shoqe*.

Njësi frazeologjike që lidhen me GJYSHIN

U bë gjysh në vatër (dikush) u bë barrë për dikë, duhet ta mbajnë të tjerët a të kujdesen të tjerët për të sështe më zot I vetes ; * në moshën tënde është turp të bëhesh gjysh në vatër.

Gjysh pas gjyshi, nga njëri brez në tjetrin, që prej kohësh të lashtë * ne jemi gjysh pas gjyshi në këtë vend e ju na vini që prapa diellit e na mësoni.

Gjysh stërgjyshi sh. Gjysh pas gjyshi. * ne jemi nga një fshat i rrethit të Akitës, kemi qenë fshatarë, gjysh stërgjysh .

GJYSHJA

Në Toskëri, po edhe gjetkë në trevat shqiptare si formë politese e mirësjelljeje ndaj grave të moshuara qoftë edhe të panjohura, përdoret fjala *nënë / na:n* (dhe variantet *krahinore* të saj: *nane, na:n, nëne*):

Në Gegëri, sidomos në viset malësore të Veriperëndimit si fjalë mirësjelljeje për gratë e moshuara përdoret fjala *loke*, që sigurisht përbën një shkurtim të *nanëloke*; Në Prilep: *anko, nane, tata, ane*

Për plakun më të moshuar të shtëpisë, përgjithësisht edhe të krejt fisit a më gjerë, në Veri është përdorur dendur zbulimi *a:p-a*: Si ke *njeh a:p*? Në Prilep përdoret *buçi, age, kurse* fjala apo përdoret për vëllain më të madh.

Me emrin *gjyshe* ka qenë emëruar nëna e nënës dhe nëna e të atit. Për gjeneratat para *gjyshes* dhe para *gjyshit* janë quajtur *stërgjyshet* ose *stërgjyshërit*.

LIDHJET FAREFISNORE SIPAS GJAKUT

Anëtarët e një familjeje sipas vijës së sipërme:

NËNA (prindi femër)

Deri te përdorimi i emrit nënë erdhi duke përdorur prindi nënë, nyjën e përparme në dhe fjalën anë, domethënë shprehjen “në anë”. Këtë shprehje nëna e përdorur në rast kur foshnja ose fëmija i vogël, sidomos natën, në terr, kur ai e shpreh pakënaqësinë dhe frikën e vet duke qarë, e në raste të këtilla, e ëma i thotë fëmijës: “Çe ku jam, në anë, çë në anë.” Pra, i tregon fëmijës se ajo është në anë, d.m.th. është pranë fëmijës. Duke e përsëritur shpesh këtë shprehje, “në anë, në anë”, me qëllim që fëmija ta ndjejë veten të sigurt pranë nënës dhe të mos ketë frikë. Kur rriten fëmijët e përvetësojnë shprehjen e komponuar: n (- ë) + anë = nanë; n (- ë) + onë = nonë; n(- ë) + ënë = nënë; n (-ë) + enë = nenë. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017).

Në Toskëri, po edhe gjetkë në trevat shqiptare si formë politese e mirësjelljeje ndaj grave të moshuara qoftë edhe të panjohura, përdoret fjala nënë / na:n (dhe variantet krahinore të saj: *nane, na:n, nëne*):

Emërtime sinonimike për nënën në të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut: *tate, nane, ane, mami* (Prilep), *nëna, nana, nona, nanushi, tata, mami, nuçja, lojla, lulja, nause, enge*.

Në të folmen e Matit, kemi : *na:n, mam, mami, te-ja* (plaku, plaka) jot‘am (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Njësi frazeologjike që lidhen me fjalën “NËNË”

Kërkon babën e nanën, kërkon shumë shtrejtë, të rjep.

Saraf i dreqit, për një dhi të mer lopën, të kërkon babën e nanën. Kërkon babën e nënën, që do të thotë të ve një çmim të paparashikueshëm një çmim që krahasohet me shpirtin.

Ju bë nënë e baba (dikujt) i qëndroi afër, u kujdes shumë për të, iu bë si prind, sidomos në vështirësi.

Në fshatin tim përdoret kjo shprehje kështu shumë por e afërt me këtë *Ja bo si non e bab*, në të shumtën e rasteve përdoret kur i merr në mbikëqyrje jetimë të kujdeset për to ashtu si prindërit e tyre.

-*S'bën nëna* (dikë) është shumë i mirë, nuk e ka shokun; nuk i gjendet shoku.

Tek ne thuhet: *s'bon nona qetër ma*, që do të thotë është i pazëvendësueshëm, nuk ka si ai.

Ca të nënës e ca të mjerkës nuk shihen të gjithë njëllor, njëri trajtohet më mirë e tjetri më keq, njërin e duan e tjetrin jo.

Njoni i nonës e qetri i mjerkës, thuhet atëherë kur njëri fëmijë trajtohet keq nga të tjerët, bëjnë diskriminim në mes tyre.

Si e ka lindur nëna, lakuriq, i zhveshur.

Tek ne thuhet: *si me dal shtaj pi nonës*, kjo shprehje në të shumtën e rasteve përdoret për vajzat të cilat janë të veshura gati lakuriq, janë shumë të zhveshura.

Edhe sikur nëna të më ngjallet, kurrë! çfarë do që të ndodhë, ehe të më vijë më e mira që mundet të bëhet (për diçka që s'dua ta bëj)

Tek ne përdoret po e njëjta *ene nona me mu ngroj pi vori*, jo që do të thotë kur nuk mund të ndodhë që të bëj diçka që unë nuk dua, që mua nuk më pëlqen ta bëj.

Është ritur me dy nëna, thuhet për dikë që ka trup të bëshëm e shëndet të mirë

I ka vdekur nëna (diçkaje) ka ngecur keq diçka, është prishur, nuk punon, është punë e mbaruar, plotësisht e sigurt.

I vdiç nona ksaj pune ose *I vdiç nona kti muabeti*, do me thënë që kjo shprehje përdoret për diçka që veç ka marrë fund ka mbaruar e tëra ajo gjë është më se e sigurt.

Gjal i nonës, gjal i mjerkës thuhet kështu sepse ai trajtohet ndryshe nga fëmijët e tjerë sepse njerka atë e lazdron sepse e ka djalë të vetin në krahasim me të tjerët prandaj edhe atë e trajton ndryshe.

Kërkon babën e nanën, kërkon shumë shtrejtë, të rjep.

S'ka burrë (nane) s'ka njeri të lindur që t'ia dalë në krye një punë e që ti dalë përpara dikujt.

Tek ne përdoren dy shprehje por me të njëjtin kuptim

s'ka bur none dhe

s'ka bir none, që do të thotë nuk mund të jetë dikush më i fortë se unë po nëse don të provoj forcën le të më del ballë.

Dridhet fëmija në barkun e nënës (sh) dridhet foshnja në barkun e nënës. kur ka frik për diçka është duke ndodhur diçka që dridhet edhe fëmija në bark.

Dridhet ene caulli nbarkin e nonës.

Iu bë (iu gjend) nëna e baba (dikujt) I qëndron afër, kujdeset shumë për të; iu bë si prind sidomos në vështirësi. * çunin e kanë shtruar në shtëpinë time, Dana iu gjend nën e baba. Se bën nëna (dikë) është shumë I mirë, është i vacantë ;

Ca të nënës e ca të njerks, nuk shihen të gjithë njësoj, njëri trqjtohet më mirë se tjetri * shoferët mernirn në udhë kë të donin, ca të nënës e ca të njerks.

Si e ka lindur nëna, lakuriq I zhveshur krejt, cullak * na urdhëruan që ti hiqnim teshat e të mbeteshim sin a kish lindur nëna.

Edhe sikur nëna të më ngjallet , kurrë, ç'far do që të ndodhë edhe të më vijë më e mira që mund të bëhet (për diçka që s'dua ta bëj.

I ka vdekur nëna (diçkaje) thjeshtligj .1. ka ngecur keq diçka; është prishur, nuk hecën, ka marrë fund * iu afrua motorrit, futi kokën nën kapak dhe u bind se atij I kish vdekur nëna.

BABAI

(prindi mashkull)

Emrin e prindit atë, kur e krahasojmë me emrin babë, që të dy këta emra kanë të njëjtin kuptim dhe emërojnë prindin mashkull **atë** ose **babë**. Nga njohuritë që kemi për këta dy emra dhe nga analiza të gjithanshme, fare lehtë mund të arrijmë në përfundimin se emri **atë** është i gurrës shumë të vjetër të gjuhës shqipe, ndërsa emri **babë** është i periudhës së sundimit osman, d.m.th. është turqizëm (Krosi - hozir.org: 14.02.2017).

Emrat përkëdhelës dhe thirrjet për respekt në emërtimin e babait

Nëpër të folme të ndryshme, babai emërohet: *aga, ago, age, ato, babi, babo, babushi, puça, puçi, lala, voni, koni, ata*. Në të folmen e Matit, kemi : *ba:b, ba:, babi, babai, tet, tat, i jati* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

bac, -i 1. babë, 2. vëllai i madh. Në të folmen e Petreshticës fëmijët i thonë babës babë, bac (fëmija i parë) dhe agë.

agë – Aga Met (Mehmet, në anë të Gjilanit, nën ndikimin e turqishtes).

Njësi frazeologjike:

Si i ati dhe i biri njësoj janë, i kanë ngjarë njëri tjetrit (për dy njerëz) *bëmë baba të të ngjaj.*

Në të folmen urbane të Gostivarit, thuhet *si baba biri*, që do të thotë kur fëmija i ngjan në shumë gjëra prindit, qoftë vepra të mira qoftë për të këqija.

Bëmë baba të të ngjaj thuhet kur fëmija ngjan shumë me prindin në pamje, në sjellje e në mendime, *si i ati dhe i biri*, hiq e vër atë vetë.

Ja ka kput krajen babës, që do të thotë që fëmija i ka ngjarë babës aq shumë sa që gati janë të njëjtë në çdo gjë në karakter, në mendime, në sjellje etj

Ca të babait ca të njerkut njëri trajtohet mirë e tjetri keq pa të drejtë; ca të nënës e ca të njerkes.

Për njonin bab e për qetrin mjerk, që do të thotë kur babai bën diskriminim në mes të fëmijëve kur njërin e trajton shumë mirë qoftë materialisht qoftë në ndonjë aspekt tjetër, me njërin sillet ashtu siç i takon një prindi të sillet e kurse tjetrin largon gjithmonë nga vetja e vet prandaj edhe thuhet kjo shprehje.

Eja baba të të tregoj arat, (vreshtat) iron.sh.i tregon (I rëfen) babait arat (dikush)iron.

Ai se di për vete e do të më mësoj mua!

Kërkon babën e nanën, kërkon shumë shtrejtë, të rrjep.

Baba araq, biri shkatraq - janë identik në sjellje. (Ibrahimi 2007:201)

Baba pa let, biri npazar - kur i kryen punët para kohe. (Ibrahimi 2007:201)

Bom bab të t'le bir - veprim identik. (Ibrahimi 2007:201)

Bom bab të t'gjaj - i biri ngjason me të atin. (Ibrahimi 2007:201)

En baba t'grajet pi vori - në asnjë mënyrë. (Ibrahimi 2007:201)

Gjali me shaum baballar metet pa ksul - jetimi mbetet në rrugë. (Ibrahimi 2007:201)

Mos ja difte babës sll^oqt - bëhet më i mençur sesa që është. (Ibrahimi 2007:201)

Nema baba ti rresht mizët - ka kush kujdeset për ty. (Ibrahimi 2007:201)

Pi çar babe, aqish fmai - fëmija i përngjan babait. (Ibrahimi 2007:201)

Si baba- biri - të dy ngjasojnë me njëri-tjetrin. (Ibrahimi 2007:201)

Bëmë baba të të ngjaj, thuhet kur fëmija ngjan me prindin shumë në pamje, në sjellje e në mendime.

Ca të babait e ca të njerkut, njëri trajtohet mirë e njëri keq pa të drejtë; Nuk i do dikush të gjithë njësoj, nuk përkujdeset për të gjithë barabart.

Eja baba të të tregoj arrat (vreshtin) ! Iron. sh i tregon (I rrëfen babait arrat.

Të kërkon babën e nënën (dikush kërkon shumë shtrenjtë të rrjep)

Babë pas babe sh. Brez pas brezi. Babë pas babe na I kan lënë të parët tanë.

I ATI

Burri i martuar që ka pasur fëmijë, djemtë dhe vajzat e tij, atë e quajnë **atë**. Në shqip emri i prindit atë përdoret ndryshe edhe babë. Emri **atë** përdoret tek arbëreshët e Italisë, te të cilët mungon plotësisht emri babë. Ky është një fakt se atje ku nuk kanë sunduar osmanllinjët, te ata shqiptar, pra, nuk përdoret emri babë. Përkundrazi, emri babë dominon në trojet shqiptare në Ballkan, ku më gjatë në kohë ka sunduar perandoria osmane; Emri atë është më i përhapur në toskërisht se sa në gegërisht. Emrat atë dhe etni përdoren në troje më të kufizuara te gegërishtes, sidomos në vise ku ka pasur më pak ndikim osmanllishtja;

Termi **atë** shihet qartë se ka gjetur një formim të plotë të brendshëm të gjuhës shqipe, duke formuar shumë emra të përgjithshëm të anëtarëve të familjes, si: *date, dadë, teze, kunati, kunata* etj. Përkundrazi, emri **babë** nuk është zhvilluar te emrat e anëtarëve të familjes. Nga kjo mund të përfundojmë se emri atë është formuar krejtësisht në mënyrë të natyrshme qysh nga koha e formimit të familjes te pellazgët. Përkundrazi, emri babë ka filluar të përdoret nga koha e sundimit të osmanllinjve. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017)

Në njëjës thuhet atë dhe në shumës thuhet et apo etër (toskërisht) dhe etni (gegërisht). Në njëjës thuhet: Atë i fëmijëve. Ndërsa në shumës thuhet: Etërit (etnit) e fëmijëve. Për të parët tanë thuhet: Etërit (etnit) e trojeve tona. Shumësi etër dallohet në të dy dialektet e gjuhës shqipe, sepse etër me r-ë përdoret në toskërisht, ndërsa etën me n-ë përdoret në gegërisht. Forma geqe me n-ë, etni, është përhapur edhe në gjuhët e tjera, si etnos në greqisht, etnum në latinisht dhe kështu si term ka marrë përmasa internacionale.

Emri **atë** kur skajohet bëhet *ati* ose *ata*. Nga atë kemi të atë, t'atë, prej nga kemi tatë, e këtë kur e skajojmë formohet tati ose tata. Si formë e veçantë, nga i ati e kemi i jati. Në shumës, nga etë kemi të etë ose pa -ë, t'etë, prej nga kemi etër ose etrit, apo etën ose etnit. Pastaj, prej etni kemi etnitet, etnik etj. Prej emrit atë kemi atnor, atësi, atërisht etj.

Te emrat e prindërve nënë dhe *ata* ose *tata*, a-ja fundore, edhe pse është nyje e prapme, përsëri rrënjën e ka te folja me qenë a[^] si formë më e vjetër, e cila si relikto ka ngelur dhe përdoret edhe sot në gegërishten e veriut, krahas përdorimit të ë-s, o[^] dhe e[^]-s me të njëjtin kuptim: a[^]shtë, o[^]shtë, është dhe e[^]shtë. Prej kohës kur fillon martesja në çift krijohet familja ku, krahas emrave të prindërve nënë dhe at, sipas pozitës në familje, në fillim marrin emra të përgjithshëm. Nga emri i prindit **atë** dalin emra të tjerë familjarë, siç janë: *date, dadë, teze, kunata e kunetër*. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017).

Njësi frazeologjike me “ATP”

Atë pas ati, (sh) brez pas brezi.

Si i ati dhe i biri njësoj janë, i kanë ngjarë njëri tjetrit (për dy njerëz) *bëmë baba të të ngjaj.*

Në të folmen urbane të Gostivarit, thuhet *si baba biri*, që do të thotë kur fëmija i ngjan në shumë gjëra prindit, qoftë vepra të mira qoftë për të këqija.

Atë pas ati, nga njëri brez në tjetrin; gjysh stërgjyshi, brez pas brezi,.

PRINDËR

(Nëna dhe babai kundrejt fëmijëve. Prindër të dashur (të dhembshur, të kujdesshëm).

Në të folmen e Prilepit dhe Krushevës kemi *baballa:r*.

GJYSHJA

(Nëna e prindit)

Kjo formë në trevat shqiptare përdoret: *mëmëmadhe-ja* (mëma e madhe), *nanmadhe-ja* (< nana e madhe), *nenamadhe* "gjyshe, nëna e babait" (Anamal) dhe *kadna:n-a* (Ahmetaj 1996:144,205) në anët e Krajës (besojmë nga *kadëna* "zonjë " + nanë), *mëmëlashë-a* (< mëmë e lashtë), *hankobardha*, *babëloke-ja* "gjyshe" e *nanloke-ja* dhe forma e shkurtuar *loke-ja*, *na-nagjyshe-ja*. Këtu u takon të përfshihen edhe emërtimeve që vijnë nga përngjitja e një togu përcaktues: *mëmatacë-a* (mëma e tatës) në diasporën arbëreshe të Italisë, *nanbabe-ja* (<nana e babës),

Në të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë takojmë këto emërtime: *nono*, *haxhi nona*, *nënuçe*, *noçe*, *nona e babit*, *ane*, *nanaplak*, *nanuçka*, *nanuç*, *nuçe*, *haxhinene* ose *axhica* është emërtuar nëna që ka shkuar në haxh.

nandaje-a (<nana e dajës), *babdaj-a* (<baba i dajës) në gegërishten veriperëndimore, *dajgjysh-i* "babai i nënës për mbesat e nipat" (Anamal) (Ahmetaj 1996:74) etj., *motërtatë* (motra e tatës) në të folmet e arbëreshëve të Italisë etj.

Në të folmen e Shkupit, emri *nenë* ose *nene*, sot nuk përdoret siç përdoren format *nënë*, *nanë* dhe *none*. Me fjalën *nene* emërohet nga nipërit e mbesat nëna e të atit (babait), gjegjësisht nëna plakë ose gjyshja për nga i ati. Prej emrit *nene* me të cilin kanë quajtur nënën e të atit është emëruar dikur edhe gruaja më e vjetër, e cila ka pasur prirje për të vajtuar të vdekurit. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017)

Gjyshja, *nono*, *haxhi nona*, *nënuçe*, *noçe*, *nona e babit*, *ane*, etj.

PLAKË E MOÇME

Në qytetin e Tiranës dhe në rrethinat e tij, banorët tipikë tiranas përdorin dendur edhe *ije-a* "gjyshe, grua e moshuar" Krahas saj, jo vetëm në Tiranë, po edhe përgjithësisht në Shqipëri të Mesme, me këtë kuptim ndeshim fjalën *mome*: *Urrno ulu ktu, mome, se je lodh.*

Në Toskëri, po edhe gjetkë në trevat shqiptare brenda kufijve të sotëm të Republikës së Shqipërisë, funksione të tilla, si formë politese e mirësjelljeje ndaj grave të moshuara qoftë edhe të panjohura, përdoret fjala *nënë* / *na:n* (dhe variantet krahinore të saj: *nane, na:n, nëne*):

Në Gegëri, sidomos në viset malësore të Veriperëndimit si fjalë mirësjelljeje për gratë e moshuara përdoret fjala *loke*, që sigurisht përbën një shkurtim të *nënëloke*; Në anët e Shqipërisë së Mesme si dhe më poshtë deri në anët e Myzeqesë, me këtë vlerë përdoret fjala *lalë*; Në qytetin e Gjirokastrës e në rrethinat e tij ka përdorim të gjerë fjala *anë-ja* "grua e moshuar, gjyshe e moçme", mbase me origjinë nga greqishtja; Në qytetin e Vlorës e në rrethinat e tij, shpesh, si respektformë e tillë përdoret fjala *xhixhe* / *xhexhe*; Jo rrallë përdoret edhe *dede*.

Me interes janë këtu edhe disa respektforma të formuara me fjalët *hanko*, vjehërr + mbiemrin e bardhë: *vjehërrbardha*, si dhe *nusebardha*, që na dalin në të folmen e Ulqinit (Ahmetaj 1996: 207) e gjetkë. Në anën e Prilepit dhe Krushevës për gjyshe e moshuar përdoren dy terme: *anko-ja* (plakë e moçme të krejt fisit), dhe *kad/e-ja*, si respektformë për gratë e moshuara të njërit vëlla (Ibrahimi 2007:44).

Në të fomen e Matit për fjalët **gjysh e gjyshe** të standardit kemi: *nanbija*, *nanmadhja*, *nanloke*, *nancurre*, kjo e fundit lidhet me faktin se gjyshja u thotë fëmijëve të vegjël currat e mi, me kuptimin të vegjëlit, të dashurit e mi, të mirët e mi. Ka dhe raste të tilla kur mbesa i thotë gjyshes së saj cakloshe, sepse ajo iu thërret të gjithë fëmijëve: hajdeni ke loshja, o loshat e mi, dhe prandaj asaj i mbeti nga nipërit dhe mbesat ky emër.

Ka dhe raste të tilla kur mbesa i thotë gjyshes së saj cakloshe, sepse ajo iu thërret të gjithë fëmijëve: hajdeni ke loshja, o loshat e mi, dhe prandaj asaj i mbeti nga nipërit dhe mbesat ky emër. (HAS-HYSAJ 2015:223). Në të folmen e Matit, kemi : *xhyshja*, *nana*, *nandaje*, *nanbije*, *nanmera*, (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

GJYSHI

(Babai i prindit)

Kur emri *atë* ose *tatë* bashkohet me fjalën *lok*, formohet emri *atlok* ose *tatlok*, që është emër përkëdhelës me të cilin quhet **gjyshi**. Si emër përkëdhelës përdoret me emrin *atlosh* ose

tatalosh që, po ashtu, i thuhet **gjyshit**. Kohëve të fundit, shprehja *atlosh* po zbehet dhe po dominon më shumë shprehja *atlok*, duke e nderuar dhe lartësuar me titullin *lok*, si mësues, si edukator dhe si profetues. (Krosi - hozir.org: 14.02.2017)

Në të folmet konservative e sidomos në diasporën arbëreshe të Italisë, ndeshim këto respektforma për gjyshin: *tatëmadhi* (< tata i madh), *tatëjashtë-i* / *tatëlashë-i* (< tata i lashtë), *Ijalbukur-i* (<ljala i bukur). prej emrit atë ose tatë kemi atzot ose tatzot, atmadh ose tatmadh dhe atgjysh ose tatgjysh. Të gjithë këta emra thuhën me kuptim të emrit gjysh, që është i ati i atit ose i ati i nënës. Te shqiptarët e Sicilisë me formën tot quhet gjyshi.

Në të gjitha këto emërtime, siç mund të shihet, kemi të bëjmë me një izoerge Nga trevat e tjera shqiptare emërtime të tjera që duhen përfshirë në të njëjtën izoerge janë edhe : *tatëlosh-i*, *babëlosh-i* dhe format e shkurtuara *losh-i* /*josh-i* "gjysh", *babëlok-u* *babamadh-i*, *babaplak-u*, *babazot-i*, *babagjysh-i*.

Në të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë ndeshim këto emërtime: *ago*, *aga*, *ata*, *atush*, *baba bamadh*, *babuç*, *babuçka*, *babush*, *babo*, *babaplak*, *xhula*. *Haxhibaba* dhe *axhibaba* – është quajtur babai që ka shkuar në haxh.

Gjysh pas gyshi, nga njëri brez në tjetrin; gjysh stërgjyshi, brez pas brezi, **atë pas ati**.

Tek ne përdoret shprehja **ded mbas dedi**,që vjen nga gjuha maqedonase at mbas ati që do të thotë brez pas brezi, gjërat që i kemi trashëgim nga të parët tanë.

Në të folmen e Matit, kemi : Xhyshi, baba, lala, babxhysh-i, baxhysh, (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Në të folmen e Matit, kemi : xhyshi, lala, baba, babdaja, baxhyshi (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Gjyshi –*haxhi baba*, *ago*, *atush*,

STËRGJYSH

Në të folmen e Matit, kemi : Stërxhysh, baba i vjetër, ose i madh, lala (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

STËRGJYSHE

Në të folmen e Matit, kemi : Stërxhyshe, nana e madhe, tetja, lokja, xhyshja e vjetër ose xhyshja e madhe (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

ANËTARËT E NJË FAMILJEJE SIPAS VIJËS SË POSHTME:

FËMIJË

Dridhet fëmija në barkun e nënës (sh) dridhet foshnja në barkun e nënës. kur ka frik për diçka është duke ndodhur diçka që dridhet edhe fëmija në bark.

Dridhet ene caulli nbarkin e nënës.

Me fëmijë e (me) rropulli me të gjithë e me gjitha ç'ka shtëpia; me njerëz e me çdo gjë; me laçka e me plaçka.

Fëmijë i vogël: njomja

CAULL

(Fëmijë)

Me caull e me maull, që do të thotë krejt sa ishin, të gjithë që janë në shtëpi, si p.sh. *Na kanë ardh ndarsëm ma caull e me maull.*

MXHOVI

(Fëmijë)

Si metën mxhovit pa buk / angër - nuk është edhe aq keq. (Ibrahimi 2007:241)

Raiten mxhovit - rraiten gajlet - vështirësohen punët. (Ibrahimi 2007:241)

Mos u bo si mxhovi - bëhu serioz. (Ibrahimi 2007:241)

Sa ni mxhovi ka men - jo serioz, flet pa lidhje. (Ibrahimi 2007:241)

Llafmxhovini - biseda jo të lidhura. (Ibrahimi 2007:241)

Mxhovini osh si r^uosa - fëmijëve t'u kushtohet kujdes të veçantë. (Ibrahimi 2007:241)

Copa u bon mxhovit - u hyri grindja, u zunë njëri me tjetrin. (Ibrahimi 2007:241)

E BIJA

(Femra e lindur nga nëna, e atësuar nga babai)

Në terminologjinë e sferës familjare për emërtimin dhe nocionin e vajzës në ligjërimet e Kosovës bëhet ky distinkcion leksikor e semantik (Murati):

Çikë – vajzë e pamartuar,

Çikë devojkë – vajzë e rritur për martesë, dhe

Bijat – vajza të martuara.

Burrneshë – virgjëreshë e përbetuar, e cila merr rolin e burrit në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë.

Si e ëma dhe e bija mospërf. Janë njësoj, nuk kanë dallim * si e ëma dhe e bija, flak morri shtëpija (flet) si e ëma e Zeqos majë thanës (dikush) thjesht ligj. Flet kotë, pa u menduar ; thotë gjepura, thotë gjëra largë së vërtetës.

I BIRI

(Mashkulli i lindur nga nëna, i atësuar nga babai)

Biri i yqit - kurrkush. (Ibrahimi 2007:203)

Bon bir tët gjaj - i biri i ngjan krejtësisht të atit edhe me vese. (Ibrahimi 2007:203)

Si i ati dhe i biri - njësoj janë, i kanë ngjarë njëri tjetrit (për dy njerëz)

bëmë baba të të ngjaj.

si baba biri - që do të thotë kur fëmija i ngjan në shumë gjëra prindit, qoftë vepra të mira qoftë për të këqija.

Djalli me të birin - të gjithë pa dallim, edhe ata që duhen edhe ato që nuk duhen.

MBESA

(Vajza e fëmijës)

Emërtimet sinonimike nga ana e nuses për mbesat: nazli qibar mbesa, lira në jahat - lira në çardak qifli qibar mbesa me tabiat.

Në të folmen e Matit, kemi : Mesa (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

STËRMBESË

Në të folmen e Matit, kemi : *stërmesa* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

NIPI

(Djali i fëmijës)

Në të folmen e Matit, kemi : *Nepi* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

STËRNIP

Në të folmen e Matit, kemi : *Stërnepi* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

ANËTARË TË NJË FAMILJEJE SIPAS VIJËS ANËSORE TË GJAKUT

MOTRA

(Femra e lindur nga nëna e njëjtë, e atësuar nga i njëjti baba)

Emërtimet sinonimike për motrën më të madhe:

Nëpër të folme shqipe përdoren edhe: *dada, aba, ablla, abllo, tata,, tato, tatuçe, tato, tata e madhe, tata e vogël, lule, daduçja, dada. abushja, abalule, dadamotër, dadaxhark, dadaçele, dadagjul.*

Në Shqipërinë Veriore kanë qenë shumë e përdorshme fjala *da:d-a* për femrat e rritura, kurse në të folmen e Matit, kemi vetëm *motër* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

(*janë*) *motër e vëlla* .1. ngjajnë shumë s'i dallon dot; * *motër e vëlla janë*, aq shumë ngjajnë

VËLLAI

(Mashkulli i lindur nga nëna e njëjtë, i atësuar nga i njëjti baba)

Emërtimet sinonimike për vëllanë më të madh: Në Shqipërinë Veriore kanë qenë shumë të përdorshme fjalët *bac-i / ba:c-a*, për meshkujt në moshë mesatare, dhe *da:d-a* për femrat e rritura. Në radhë të parë, fjalët *bac, ba:c* dhe *da.d* përdorshin brenda marrëdhënieve familjare e fisnore: *bac-i apo ba:c-a* thërri tej vëllai i madh nga më të vegjlit në shenjë respekti e zbulimi. Kemi disa forma emërtimi në Maqedoni; *apo, abi, aga, aja, puço, puça, pçaj madh, pçaj vogël, lalo, bac, lala.*

Fjalët sinonimike në emërtimin e vëllait të madh: *lala, pucja, aga, abia, aja,*

La-ja – 1. vëllai i madh. *Erdhi Laja. La Azir* (Gjonaj, Hasi i Prizrenit). 2. shprehje për të nderuar më të vjetrin. *Lajë Miftari*(Zym, Prizren).

Lälë – *bacë* (Opojë, Prizren).

Bacë – vëlla i madh; emërtim për të dashurit dhe të afërmit në shenjë respekti ndaj më të vjetërve; *bacalok, baclok* (Deçan). *bac/ bac/bal* (*Baca Adem, Bali Adem*).

Bac, -i 1. *babë*, 2. *vëllai i madh*. Në të folmen e Petreshticës fëmijët i thonë *babës babë, bac* (*fëmija i parë*) dhe *agë*.

Në të folmen e Matit, kemi : *vllau, llau, lau, la* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Sikur eshe vëllai të me lindë! kurrë ç'farë do që të ndodhë, edhe sikur të më vij diçka shumë mirë (për diçka që sdua ta bëj).

Vëllezër siamezë libërë. Njerëz shumë të ngjajshëm në pamje, në mendime, në sjellje e në shije; njerëz të lishur fort që nuk ndahen kurrë * këta vëllezër siamezë në letërsi si ndan dot as nga stili, as nga ligjerimi artistik.

KUSHËRI

Në të folmen e Matit, kemi : Kushren e I. II. III. IV (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

KUSHËRIRA

Në të folmen e Matit, kemi : Kushre i I. II. III. IV (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

TEZJA

(Motra e nënës, gruaja e vëllait të babait, gruaja e vëllait të nënës)

Me fjalën teze emërohet motra e nënës. Por të gjithë të rinjtë dhe të rejat, teze quajnë të gjitha femrat më të mëdha që janë të gjakut të nënës, të dala nga gjiri atëror i nënës. Emri teze është formuar nga emri i të atit të nënës. Prej emrit të etë ose t'etë, është formuar emri tetë, që kur skajohet, bëhet tete ose teta, apo tetja. Siç është e ditur nga fonetika historike e gjuhës shqipe, t-ja është shndërruar në z-ë, prej nga në vend të tete kemi teze, ose nga tetja kemi tezja (Krosi - hozir.org: 14.02.2017).

Në të folurat e ndryshme të gjuhës shqipe, krahas emrit **teze**, kemi edhe forma të tjera, siç janë: *tezuçe, tete, tetja, tetushi, tezja baçe, tezja mide, tezja lule, tezja mer, teto, tetoja, tete, teta, tetja, tetushi, tezja bace, tezja mide, btezja mer* etj. Në të folmen e Matit, kemi : Teze (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

TEZAK

Djali i motrës së nënës, djali i tezes. Ka dy tezakë. Jemi tezakë.

XHAXHAI

(Vëllai i babait, burri i motrës së nënës, burri i motrës së babait)

Në izoerget që u takojnë fjalëve të farefisnisë (*ha:ll, da:j, teze, mi:xh, xhaxh, da:xh, da:d*) + emrat vetjakë, themi se për krahinën tonë shkon ndarja e parë e përbërë: nga togjet e përbëra me emrat e farefisnisë a lidhjeve të tjera familjare në trajtë të pashquar + emrin vetjak në trajtë të shquar p.sh.: *ha:ll Tana, teze Fatimja, da:jë Aliu, mi:xh Abazi*, por kemi dhe të tilla: *xhaxhi Naim, daxha Ibrahim, dada Selvije* etj. (HAS-HYSAJ 2015:223).

Fjalët sinonimike në emërtimin e xhaxhait:

Në të folmen e Prilepit paraqiten sinonimet: *xha, xhajçe, xhaxhi* (Ibrahimi 2012:). Në të folmet tjera të vendbanimeve shqiptare në Maqedoninë e Veriut i takojmë edhe variantet: *Aga madh, puci, aja, xhaxhi, lali, axha, kia, date* etj.

Në anët e Kosovës, fjala *mixh-a "xhaxha"* apo *mixhak-i "xhaxha"*, krahas përdorimeve të mirëfillta të barasvlershme me sinonimet a togfjalëshat e qëndrueshëm përkatës: vëllai i babait, djali i xhaxhait përdoren edhe si respektforma për të moshuarit dhe, në një farë mënyre, zëvendësojnë fjalën zotni/zotëri të mjediseve qytetare. Në Maqedoni ndeshim format: *agamath, aja, axhi, axha, axhul, mixha, kia, lala, abi, xhaxhi, xhaje, xhajko, xhaxhul, xhajçe, xhuli, puci, puca*. Në të folmen e Matit, kemi : *xhaxhi, mixh, mixhe* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Përdorimi i emrit "*xhaxha*" si respektformë. Njëra përfshin pjesën e Malësisë së Madhe, ku togjet përbëhen kryesisht nga emri i farefisnisë a i lidhjeve të tjera familjare në trajtë të pashquar + emrin vetjak në trajtën e shquar. Në rrethin e Prilepit të Maqedonisë, togjet të burrat më të moshuar bëhej kryesisht nga emri i farefisnisë në trajtën e pashquar dhe emri në trajtën e shquar duke u aglutinuar, p.sh. *xhademi* (për xha Ademi), *Xhalami* (për xha Islami), *xhadakvoja* (për xha Sadiku), *xha Junuzi, xha Sherifi* etj. Për emërtimin e grave togjet përbëhen kryesisht nga emri i farefisnisë në trajtën e pashquar *anko* dhe emri i burrit duke shtuar prapashtesën sllave –**icë**, p.sh.: *kade islamaic, kade sherifaic, kade jakupaic* etj, por në rastet kur e pranishme është vetëm një plakë emërtohet vetëm me emrin *kade*.

XHAJOJCA

Prej kohës kur fillon martesë në çift krijohet familja ku, krahas emrave të prindërve nënë dhe at, sipas pozitës në familje, në fillim marrin emra të përgjithshëm. Nga emri i prindit **atë** dalin emra të tjerë familjarë, siç janë: *date, dadë, teze, kunata e kunetër*. Me emrin datë ose date, në fillim, kanë emëruar të rinjtë dhe të rejtat vëllezërit e të atit, domethënë xhaxhinjt (mixhallarët). Vëllezërit dhe motrat më të vogla, me emrin date quajnë vëllezërit më të mëdhenj. Por, më vonë, me emrin date kanë quajtur edhe të gjithë meshkujt më të mëdhenj në familjen atërore. Pra, me këtë emër quhen edhe të gjithë burrat e tjerë, me përjashtim të burrave që i takojnë familjes së nënës, të cilët thirren dajë.

Emri dat ose date është formuar nga emri i prindit atë ose ate, duke ia shtuar prapashtesën d-ë. Kjo bëhet në këtë mënyrë: d + atë = datë, ose d + ate = date.

DADË Me emrin dadë të rinjtë dhe të rejtat quajnë motrat e të atit, por edhe të gjitha femrat më të mëdha, të cilat i takojnë gjakut atëror, por edhe të gjitha femrat e tjera, me përjashtim të femrave që i takojnë gjakut të nënës, të cilat quhen teze.

Emri dat ose date është formuar nga emri i prindit atë ose ate, duke ia shtuar parashtesën d-ë. Kjo bëhet në këtë mënyrë: d + atë = datë, ose d + ate = date.

Emri dadë është formuar njësoj si emri date, duke i shtuar parashtesën d-ë dhe duke u shndërruar t-ja në d-ë, gjë që është vërtetuar nga fonetika historike e gjuhës shqipe. Prej nga kemi: d + ate = date, por kur t-ja shndërrohet në d-ë, atëherë do të kemi: d + adë = dadë dhe emri dadë kur skajohet bëhet dada. Në favor të kësaj, na flet edhe shprehja e Buzukut: "...tadënë e t'amënë...", i cili, kur përmend tatin, t-në e dytë e ka zëvendësuar me d-në. Emri dadë është përdorur para se të përdorej emri hallë për motrën e të atit. Përderisa me emrin hallë quhen motrat e të atit dhe të gjitha plakat që i takojnë gjakut atëror, me emrin dadë, përpos motrave të atit, thirren të gjitha femrat më të mëdha, duke përfshirë jo vetëm plakat, por edhe të rejtat që janë më të mëdha se djali ose vajza në familje.

HALLA

(Motra e babait)

Për gjininë femërore, me të njëjtat vlera, në anët e Verilindjes përdoret fjala *hallë*: Aje lodh oj hall? Ish kan tunihere ni ha:ll e moqme (Kishte qenë njëherë një plakë e moçme).

Për seksin femër, me të njëjtat vlera, në anët e Verilindjes përdoret fjala *hallë*:

Emërtimet sinonimike për hallën: *abalule, abushe, abaqe, dadamotër, dadaxhark, dadacele, dadagjule, daduç, halla Idajet, hallo, hallçe, hallçja e babit, tato, tатуце halluce, motro, halluçe, ablllo, tato*. Në të folmen e Matit, kemi : *hall, cuc halle, gjal halle*, (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Halla te shkalla që do të thotë se vajza pasi që të martohej në atë shtëpi më është e fundit d.m.th ka vendin e fundit prandaj edhe thuhet "*halla te shkalla*" ajo më nuk pyetet si më parë por tash ka krejtësisht një rol tjetër në atë shtëpi d.m.th në shtëpinë e vëllait.

Në të folmen e Matit, kemi : *teze daje, mixhe etj* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Të puth halla në të dy faqet ! Iron. Tjesht ligj . U lamë bashkë ; s'ke ç'merr më, mo sprit gjë; mori fund me kaq * sikur brisku ta kishte shpiar pak lëkurën, rësheku le të plaste dhe atëherë të puth halla në të dy faqet.

Halla- *hallo, hallçe, motro, halluçe, ablllo, tato etj*

GJYSHI (Baba i dajës) / GJYSHJA (Nana e dajës)

Në të folmen e Prilepit, por edhe të Matit , gjyshja thirret dhe nandaje, nana e dajës, babdaje, baba i dajës, xhysh, babxhysh, ose tété, te-ja, lal-a. Në zonën e Matit përdoret dendur fjala tété, me kuptimin grua e moshuar ose gjyshe; po ashtu kemi hasur në disa raste edhe trajtën ije-a, me kuptimin e nënës ose të gjyshes. (HAS-HYSAJ 2015:223).

DAJA

(Vëllai i nënës)

Emërtimet sinonimike për dajën: *dajko, dajxha, dajca, dajojca; dajca, dajojca, dejxho*. Në të folmen e Matit, kemi edhe variantet : *daj, daxh* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Nësi frazeologjike me komponentën DAJA

I thot dërrit dajë (dikush) thjesht ligj. Quan mik nga e keqja edhe atë që se do e si pëlqen ; e pranon dhe I bën qejfin një njeriu jo të mirë. * Po zotërinj ne jemi edhe kokëfortë si themi dot dërrit dajë

DAJOJCA

ANËTARËT TË FAMILJES SIPAS MARTESËS

MIK / MIKESHË

Lidhjet farefisnore sipas martesës nga ana e gruas

Në të folmen urbane të Gostivarit, interes të veçantë janë emrat që i përdor nusja ndaj të gjithë anëtarëve tjerë të familjes së burrit. Nga këto emërtime shohim respektin dhe kujdesin e madh që ka pasur nusja në shtëpinë e burrit. Kjo karakteristikë më së shumti është e pranishme edhe në fshatrat e Gostivarit dhe Tetovës.

BURRI

(Bashkëshorti)

Në të folmen e Matit, kemi: Burri, plaku, i shōçi (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Bëhet burri i mirë në sofër të huaj, thuhet për një njeri të keq që i fut hundët ku nuk i takon. që bën nderë me nderin dhe të mirën e të tjerëve.

Mbahet bur i majr nshpaj tjetër kujt, thuhet për një njeri të ligë që bën vetë keq dhe përzihet në punët e huja në shtëpi të tjetër kujt i fut hundët aty ku s' duhet.

Është bur ding, është me të gjitha cilësitë e mira njeri i fortë, trim e bujar. S'ka çka i thua është burrë ding.

Në fshatin tonë përdoret *është bur e xhims*, kur është njeri me të gjitha të mirat, burrë i fort, i ndershëm i sjellshëm, burrë i fjalës. *xhi di thaujish bur e xhims osht*.

Burrin e kallëzon besa, njeriu e fortë dhe trim e tregon fjala e dhënë. burrin e kallëzon besa.

Bur osht aj xhi e mban llafin, thuhet tek ne kështu për atë arsye se fjala e dhënë është virtyti më i rëndësishëm për një burrë dhe ves për të gjithë Shqiptarët sepse dihet që burri nuk duhet të luaj prej fjalës që e ka dhënë.

E ka burrërinë në këmbët e veta, është tamam burrë me të gjitha cilësitë e burrit.

Burri me kosh e gruja me lugë, thuhet për një shtëpi që nuk ka harmoni ku shpërdorohet pa masë.

U bë burrë, (dikush u rrit), u burrërua, ra në bylyk. Mori guxim dhe trimërohet, nuk trembet më; mori zemër.

Na a rejt gjali a bo bur, kur tash më atij nuk i frikohet syri për asgjë, tash nuk frikohet edhe nga prindit dhe prandaj përdoret se është rritur ma d.m.th nuk pyet njeri po as edhe prindërit nuk i dëgjon ato.

Burr i dheut, njeri i zoti me karakter të fort (edhe si thirror).

Bur i rond, që do të thotë (burrë i rëndë) njeri i ndershëm, njeri i fjalës, trim dhe i fortë.

S'ka burrë (nane) s'ka njeri të lindur që t'ia dalë në krye një punë e që ti dalë përpara dikujt.

Tek ne përdoren dy shprehje por me të njëjtin kuptim *s'ka bur none* dhe *s'ka bir none*, që do të thotë nuk mund të jetë dikush më i fortë se unë po nëse don të provoj forcën le të më del ballë.

PJESA II

DALLIME GJINORE TEK EMRAT FAREFISNORE

MOSZËNIA NË GOJË E EMRIT

Emrin e gruas (përkatësisht të burrit) të gjitha zonat ku jetonin shqiptarët, e veçanërisht malësorët, nuk i zinin me gojë. Në vend të emrave të tyre përdornin fjalë të ndryshme, duke u sjellur shembuj më poshtë.

1. Moszënia në gojë të emrit të burrit

Në të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut , gruaja në vend që ta përdor emrin e burrit përdor thirrje të ndryshme, duke mos e thirrur në emër: *a ndejn be, a nejne, aj i imi, burri jem, ej, eji, haxhju, hej ai, more, o burr, o njeri, o pjak, o tej , o tej pjak, or tej, a ndejn be, a xhiexhën be, aga, aj shoçi, buri jem, more, o njeri, o tej, o tej pjaku, njeriu, ai, baba i Shatit, fati , fisniku , ky, njeri, o njeri.*

Në Zall-Dardhë të Dibrës, para pjesëtarëve të tjerë të familjes në vend të emrit të burrit përdorin: *vllau jot, mixha jot* etj. Madje, në Zall-Dardhë edhe vjehrrin nuk e thërrasin me emër nusen e djalit, por i thonë thjesht nouse: *nousja e Sokolit, nousja e Ahmetit.*

Kemi këtu një mendësi tipike turke, që na kujton togfjalëshat e tillë të turqishtes: ebu "babai": ebu Kemal (babai i Qemalit).

2. Moszënia në gojë të emrit të gruas

Në Malësi të Madhe meshkujt në vend të emrit të bashkëshortes dhe të fjalëve gruoja apo shoqja përdorin, si me shaka, fjalë të tjera të sferës familjare, si p.sh. gjyshe, ndrikull, baxhi, e zoja e shpi:s etj.

Në Zall-Dardhë të Dibrës, para pjesëtarëve të tjerë të familjes në vend të emrit të gruas përdorin edhe: *nana jote: ku asht nana jote*, madje, në Zall-Dardhë edhe vjehrra nuk e thërrasin me emër nusen e djalit, por i thonë thjesht nouse: *nousja e Sokolit, nousja e Ahmetit.* Në të folmen e Matit, gjithashtu nuk zihej në gojë emri i gruas, vend emrit përdorej: *gruja, nusja, plaka, e shōçja* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Në të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut , burri asnjëherë nuk e përdorte emrin e gruas , në vend që ta përdor emrin grua përdor thirrje të ndryshme, vetëm e vetëm mos e thirr në emër: *a ndejn mi, a nejne, e imja, haxhica,ku ije mi,moj,mori, o njeri,oj gospogjo,oj*

gru,oj grue,oj nause,oj pjako, oj pjakooo, oj tej, a ndejn mi, a xhiexhën mi, mori, oj grue, oj pjako, oj tej.

Fisnike – thirrje për gruan (formim obscen), në të kaluarën, kur burri nuk e quante me emër, që lidhej kjo me natyrën sociale a me ndjenjën e turpit. Si një formim tjetër obscen përdorej dhe *Plaka*, kurse gruaja përdorte *Plaki*. (Petreshticë).

Frazeologjizma për gruan dhe burrin

Burri me kosh e gruaja me lugë, thuhet për një shtëpi që nuk ka harmoni ku shpërdorohet pa masë.

DJALI

Në të folmen e Matit, kemi : *gjali, biri, meci* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Frazeologjizma për djalin

Gjali babës ja kallzon mexhet e arës që do të thotë se në qoftë se dikush i tregon dikujt apo e mëson dikë për diçka që ai nuk e din për vete ose kur dikush më i vogël i tregon dikujt më i madh se ai diçka. *E mson voja pulën.*

Na a rejt gjali a bo bur,kur tash më atij nuk i frikohet syri për asgjë, tash nuk frikohet edhe nga prindit dhe prandaj përdoret se është rritur ma d.m.th nuk pyet njeri po as edhe prindërit nuk i dëgjon ato.

Djali pa lerë e djepi blerë, iron. thuhet kur veprohet para kohe, peshku në det e tigani në zjarr. për njerëzit e nxituar, që nuk presin radhën a nuk sigurohen më parë për diçka por vepron para kohe.

Gjali pa u li a gjepi a bgji. që do të thotë mos bën hop pa e kërcyer gardhin po çdo gjë shkon me radhë, është po e njëjtë edhe shprehja *peshki ndet e tava nzarm.*

Na a rejt gjali a bo bur,kur tash më atij nuk i frikohet syri për asgjë, tash nuk frikohet edhe nga prindit dhe prandaj përdoret se është rritur ma d.m.th nuk pyet njeri po as edhe prindërit nuk i dëgjon ato.

Djalë mamaje Iron .sh çun mamaje Iron * nuk shkohet jeta me një djalë mamaje, gruaja do burrë

(E do) si djalin e Shemrës (dikë) Iron. Nuk e do fare, e urren.

VAJZA, CUCA

Në të folmen e Prilepit kemi format, *bija, cauca*, kurse në atë të Matit, kemi : *bija, cuca, vajza* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Njësi frazeologjike me komponentin: *cucë/ cauc*

Ni cauc për mall – vetëm atë e ka

Caucnill^uok - maunill^uok - ditët jostabile të beqarisë së femrave. (Ibrahimi 2007:208)

U d^uogj për at cauc - është dashuruar tepër në të. (Ibrahimi 2007:208)

E maur bashin e caucës (gjalit) - vajza (djali) më i.e bukur. (Ibrahimi 2007:208)

Emërtimet sinonimike për vjehrrën/vjehrrin:

Për fjalët e shqipes standarde: *vjehërr-i, vjehërr-a*, nëpër të folme të ndryshme të shqipes ndeshim edhe sinonime të tyre dialektore, që paraqesin një laramani interesante dialektore.

VJEHRRRI

Për fjalët e shqipes standarde *vjehërr-i*, ndeshim edhe sinonime të tyre dialektore, si: *baba i nuses*, kryesisht në gojën e më të "moderuarve", ndërsa në brezin më të vjetër, për *i ati i nuses* përdoret *mik-u* apo *mik krejet, miku i kre:s*.

Në Malësi të Madhe, përgjithësisht, fjala *vjehërr-i* përdoret vetëm për prindërit e dhëndrit ndaj nuses; aty izoerget janë të qarta: prindërit dhe vëllezërit e motrat e nuses përbëjnë atë që quhet *gjini-ja*;

Në të folmen e Prilepit, kur merrej nusja, në oborrin e babait të nuses këndoheshin këngë me përmbajtje ofenduese, ku vjehrrri lartësohej “*jago baba*”, kurse krushku ofendohej me fjalën “*baba xhýpi*”.

BON KONAKE

Bon konake baba xhýpi, bon konak

Se do t'vije jago baba, bon konak

Do ta bjere kuti rubën, o bon konak

(Ibrahimi 2003: 95)

VJEHRRA

Edhe për fjalët e shqipes standarde *vjehërr-a*, ndeshim edhe sinonime të tyre dialektore, si: *nana e nuses*, kurse për *e ëma e nuses* ndeshet masivisht fjala *krushk-a*.

Në Malësi të Madhe, përgjithësisht, fjalët *vjehërr-i* dhe *vjehërr-a* përdoren vetëm për prindërit e dhëndrit ndaj nuses; aty izoerget janë të qarta: prindërit dhe vëllezërit e motrat e nuses përbëjnë atë që quhet *gjini-ja*;

Në Malësi të Madhe përdoren dendur edhe në trajtën e paranyjzuar: *e re:-ja, i viehrrri, e viehrra, viehrrri ëm, ëme viehërr, viehrra ëme, yt viehërr, viehrrri yt, jote viehërr, viehrrrajote*. Në krahina të tjera të Shqipërisë Veriore, p.sh., në Mirditë, dhëndri përdor të tjera emërtime për vjehrrin dhe vjehërrën: *baba i me:r* (babai i mirë), *nana e me:r* (nëna e mirë), të cilat nuk janë njësoj me togfjalëshat sinonimikë: *baba i nuses, nëna e nuses*.

Në Maqedoni përdoren emërtimet të ndryshme për vjehërrën, zakonisht nga nusja e re: *sheqer tata, sheqer aba, alltën aba, honko nene, hënëmb aba, bik nene, bis nene, hënë manja, honko nenja, hënëmb nenja, honkonene*.

Në të folmen e Prilepit, kur merrej nusja, në oborrin e babait të nuses këndoheshin këngë me përmbajtje ofenduese, ku krushka ofendohej me fjalën “*nana xhýpka*”.

Bon konake nana xhýpka, bon konak

Se do t'vije baba dajës, bon konak

Do ta bjere midis pallton, o bon konak

(Ibrahimi 2003: 95)

Për vjehërrën nga nuset kemi edhe zhargone të ndryshme, si: *farofsha, fesatxhije, haxhuze, hënëmb nenja, honkonene, honomaba, kanceri* (Lloshi 2001:177). Nëpër të folmet shqipe kemi edhe: *macja e zezë, tenxhere me presion, honkonenja, nanaxhipka, nanaxhypka, nane madhe,*

Në të folmen e Matit, kemi : *vjehrra, e ama e nuses ose gjalit, krushka*, (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

E REJA

Në të folmet shqipe të Maqedonisë, zakonisht vajza që del nga shtëpia, për të gjithë të mësipërmët, quhet *bi:-ja*; ndërsa nusja e djalit për prindit e tij është *re-ja*. Kjo traditë ka

qenë karakteristike edhe për Malësinë e madhe, por edhe për shumë të folme tjera në vendbanimet e ndryshme, ku kanë jetuar shqiptarë.

NUS/E,-JA

Emërtimet sinonimike për nusen e vëllait më të madh të burrit (kumatën): *gogufçe hënmi, sëshkraume hënëm, fëllënza hënmi, kadife hënëm, qibare hënmi, elbebi hënëm, elbebi karanfule hënmi, topkaranfile hënmi, inxhile kadife hënëm, syshkrume hënmi. inxhile kadife hënmi,*

Jengjë – Fjalë nderimi a respekti për femrat e moshës madhore të shtëpisë a të kushërinjve të burrit nga ana e nuses a ndonjë grua e re. Kjo fjalë qëndron në relacion me *efë* për burrat (Lugu i Baranit).

Hanëmbija – kështu u thotë nusja motrave të burrit që janë të martuara (Petreshticë).

Hanëmçika – kështu u thotë nusja motrave të burrit që janë të pamartuara (Petreshticë).

Hanëminxhe – gruaja më e vjetër në shtëpi nga ana e resë (Petreshticë).

Hanëmzoja – kështu e ka thirrur nusja e re kumatën e saj (Petreshticë).

Në të folmen e Matit, kemi : nusja ose reja e filanit (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Njësi frazeologjike për fjalën “NUSE”

Rri paluar si nuse, rri I heshtur dhe si në turp; rri duarkryq pa bërë gjë

Ështe nuse e ardhur dje (dikush)nuk e njeh një mjedis të ri a një punë të re.

E mban shtëpinë nuse, e mban shtëpinë të pastër dhe të rregulluar mirë.

Tek ne përdoret – e ka bo shpajën si nause, do të thotë të rregulluar mirë të mirëmbajtur etj.

Të kallzon nusen e të jep plakën, dikush të gënjen të mashtron të shet sapunin për djathë.

Po të bëhem përsëri nuse di të nusroj, kam fituar përvojë nga një punë e vështirë jam tash më në gjendje ta bëj ndryshe e më mirë.

T’bohem ene niher nause di raj, që do të thotë gjërat që i kam kaluar po t’i kthej sërish do ti kasha bërë shumë më mirë sepse tani kamë më shumë përvojë dhe e di siç duhet bërë.

E bëri nuse (dikë) sh. E bëri lule (dikë).

E boni nause tndraume, d.m.th. I dha një qytek të mirë e rrahu aq shumë sa që e bëri si “nuse”.

Ështe nuse e re (diku)nuk e njeh mirë një mjedis të ri a një punë të re, nuk është mësuar ende aty, sapo ka ardhur aty.

Nausja e rea osht ala që do të thotë ende fillimi është nuk është mësuar në ato rrethana apo në atë mjedis, nuk është adaptuar në atë rreth.

I rri nuse (dikujt), rri gati për çdo kërkesë e dëshirë. I nënshtrohet.

Rajn nause d.m.dh. nuk ja kthen fjalën për asgjë sepse tek ne nusja është ajo që duhet vetëm të dëgjojë dhe asgjë të mos flasë. Prandaj edhe thuhet kjo.

Rri (si) nuse. Nuk flet rri si me turp; nuk e hap gojën, nuk bën gjë.

Raj si nause tek ne thuhet kur dikush (zonja e shtëpisë) në shtëpinë e vet nuk prek punë me dorë nuk punon asgjë po rri si nuse, tek ne e ka këtë do me thënie.

D'boem ene njere nause aun di si da nusur^uoj - të kthehet edhe një herë, ndryshe do të veprojë. (Ibrahimi 2007:242)

E maur nausen goliq - e mori pa tesha, nuk solli pajë aspak. (Ibrahimi 2007:242)

(dikush) sh. U bë lule (dikush). * e mban mend ç'harakat ka qenë, pa shikojë tashti është bërë nuse !

Të bëhem edhe njëherë nuse di vetë si të nusëroj kam fituar përvojë nga një punë e vështirë, jam tashmë në gjendje ta bëj ndryshe e më mirë diçka * ajo kohë iku e vajti, sot kemi mend të tjera dhe të bëhem edhe njëherë nuse, di vet si të nusëroj

E bëri nuse (dikë) sh. E bëri lule (dikë) I ati ishte shumë I eger dhe mbahej krenar që e kish mposhtur, që e kish bërë nuse.

Kjo është nusja e ky është dhëndri, kjo është gjendja e një punë; këto janë rrethanat ose mundësitë për të bërë diçka * kjo është nusja, ky është dhëndr, unë skam fuqi ti ndryshoj mendjet e njerëzve.

I rri nuse (dikujt). I rri gati për çdo kërkesë e këshillë; I shërben mirë e menjëherë për çdo gjë.

Rri (si) nuse (dikush) .1. nuk flet ; rri si me turp; nuk e hap gojën * po ti, ç'më rri si nuse ke gojë ti të flasësh ? 2. Nuk bën gjë; rri duarkryq. * ç'më rri si nuse pa kape atë koshin e çojte te fiku.!

Rri paluar si nuse, rri I heshtur dhe si në turp; rri duarkryq pa bërë gjë

Ështe nuse e ardhur dje (dikush) nuk e njeh një mjedis të ri a një punë të re.

E mban shtëpinë nuse, e mban shtëpinë të pastër dhe të rregulluar mirë.

Tek ne përdoret – **e ka bo shpajën si nause**, do të thotë të rregulluar mirë të mirëmbajtur etj.

Të kallzon nusen e të jep plakën, dikush të gënjen të mashtron të shet sapunin për djathë.

Po të bëhem përsëri nuse di të nusroj, kam fituar përvojë nga një punë e vështirë jam tash më në gjendje ta bëj ndryshe e më mirë.

T'bohem ene niher nause di raj, që do të thotë gjërat që i kam kaluar po t'i kthej sërish do ti kasha bërë shumë më mirë sepse tani kam më shumë përvojë dhe e diç duhet bërë.

E bëri nuse (dikë) sh. E bëri lule (dikë).

E boni nause tndraume, d.m.th. I dha një qytek të mirë e rrahu aq shumë sa që e bëri si “nuse”.

Ështe nuse e re (diku)nuk e njeh mirë një mjedis të ri a një punë të re, nuk është mësuar ende aty, sapo ka ardhur aty.

I rri nuse (dikujt), rri gati për çdo kërkesë e dëshirë. I nënshtrohet.

Rajn nause d.m.th. nuk ja kthen fjalën për asgjë sepse tek ne nusja është ajo që duhet vetëm të dëgjojë dhe asgjë të mos flasë. Prandaj edhe thuhet kjo.

Rri (si) nuse. Nuk flet rri si me turp; nuk e hap gojën, nuk bën gjë.

Raj si nause tek ne thuhet kur dikush (zonja e shtëpisë) në shtëpinë e vet nuk prek punë me dorë nuk punon asgjë po rri si nuse, tek ne e ka këtë do me thënie.

Nausja e rea osht ala që do të thotë ende fillimi është nuk është mësuar në ato rrethana apo në atë mjedis, nuk është adaptuar në atë rreth.

KUNATI

Në gjininë mashkullore në njëjës është kunat, i shquar kunati, ndërsa në shumës është kunetërit. Me emrin kunat gruaja quan vëllanë e burrit. Nëse burri ka më shumë vëllezër, gruaja ata i quan kunetër (kunetni – gegërisht). Edhe për burrin vëllai i gruas quhet kunat e nëse gruaja ka më shumë vëllezër, i quan kunetër (kunetni – gegërisht). Kunat quhet edhe burri i motrës (d.m.th. dhëndëri).

Për formimin e emrit kunat vjen në shprehje emri i prindit atë (në njëjës) dhe etri ose etni (në shumës), por që këtu emrit atë apo etri u parashtohet fjala kun, prej nga kemi: kun + atë = kunatë, ose kun + etri = kunetri (për shumës). Kur fjalët atë dhe etër na janë të njohura prej më lartë, na ngelet të shohim domethënien e fjalës së parashtuar KUN. Fjala kun do të thotë -quan. Në Derven të Shkupit nuk thuhet qun ose quhet, por thuhet kun ose kuhet. Fjala kun është fjalë e vjetër albano – pelazge dhe shqipe, të cilën populli e përdor edhe sot e kësaj dite, e që ka kuptimin, si u tha më sipër, të fjalës quan. Emrit atë dhe në shumës etri, fjala kunë (quan) i parashtohet për të treguar se njerëzit e afërt si kunatë e kunetër i ka, i zen, apo i quan si të atit, ose si të etërve (në shumës), pra i kun si të atit, ose i kun si të etërve (etnive). (Krosi - hozir.org: 14.02.2017)

Emërtimet sinonimike nga ana e nuses për vëllezërit e burrit (kunatit): *qibar aga, tapkën qibar aga, sugar qibar aga, bajrak dylber aga, deli qibar aga, sugar kiçik aga, sugar qibar*

aga, top karanfil sugar aga, kikat qibar aga, filis qibar aga, dili çikik aga, açik, bajrak dilber aga, lalbukur , top karanfil sugar aga

Emërtimet sinonimike nga ana e nuses për vëllain e madh të burrit: *abi efendi, nazli qibar aga, ziberbik efendi, kiçik ago*

Emërtimet sinonimike nga ana e nuses për vëllain e vogël të burrit: *sugar aga, açik, bajrak dilber aga, lalbukur , lalbukur, top karanfil*

Në të folmen e Matit, po ashtu kemi emërtime sinonimike nga ana e nuses, kryesisht paraqiten format : *kunati, agai* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

KUNATA

Në gjininë femërore, në njëjës është kunatë, e shquar bëhet kunata, ndërsa në shumës kunatat. Gruaja me emrin kunatë quan motrën e burrit...Në shumës motrat e burrit i quan kunata. Nga ana tjetër, për burrin kunata quhen motrat e gruas, por edhe gratë e vëllezërve të vet, po ashtu, i quan kunata, ashtu siç është edhe në të folmen e Matit, ku kemi : *kunata* (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

Në të folmen e Gostivarit dhe të Tetovës, ekziston një numër të madh emërtimelesh të nuses ndaj anëtarëve tjerë të familjes.

Emërtimet sinonimike nga ana e nuses për motrën e burrit (kumatës, “zollvës”): *açik karanfilçe zollva, akikat qibarzollva, çibare hënmi, delije qibar zollva, dilie qibar zollva, elti hanëm, filis qibar zollva, hanëminxhekanaçiçek zollva, kimetli zollva, nazli qibar honëm, përmall sugar zollva, qibar zollva, qibare honmi, qifli qibar zollva, serbes zollva, shatarvon çapras klimi kardash honmi, simbil honmi, sirmeli qibar zollva, sugar honë zollva, sugar zollva, sugarçe honëm, top karajfile zollva, top karanfil sugare zollva, top karanfil zollva, trëndafil kadife hanëm, trëndafil zollva, elbebi hënëm, fëllënzë hanëm, gugufce hënmi, inxhile kadife hënmi, qibar hënmi, syshkrume hënmi. përmall sugar zollva, kanacicek zollva, sugar honë zollva, sugar zollva, top karanfil zollva, simbil honmi, shatarvon capras klimi kardash honmi, qibare honmi, delije qibarzollva, akikat qibarzollva, filiz qibar zollva.*

BABGJYSHI

Në të folmen e Matit, kemi : I jati i nuses ose i gjalit krushku, meku (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

NANGJYSHE

Në të folmen e Matit, kemi : Vjehrra, e ama e nuses ose gjalit, krushka, (HAS-HYSAJ 2015:224-225).

DHËNDËR

U bë dhëndër (dikush) një. U rrit djali, u bë për tu martuar. * e lashë një pëllëmbë dhe të gjeta dhëndër. 2. U vesh me rroba të reja, u vesh e u stolis si dhëndër.

Kjo është nusja e ky është dhëndri, kjo është gjendja e një punë; këto janë rrethanat ose mundësitë për të berë diçka * kjo është nusja, ky është dhëndr, unë skam fuqi ti ndryshoj mendjet e njerëzve.

DOMAZET (burri që jeton në shtëpinë e gruas)

Domazeti osh ma i zi pi gërvanit - jetë e vështirë. (Ibrahimi 2007:212)

NJERKA

(Gruaja e dytë e një burri kundrejt fëmijëve që ka ai me gruan e parë; gruaja e babait)

Ca të nënës e ca të njerkes nuk shihen të gjithë njëllorj, njëri trajtohet më mirë e tjetri më keq, njërin e duan e tjetrin jo.

Njoni i nonës e qetri i mjerkes, thuhet atëherë kur njëri fëmijë trajtohet keq nga të tjerët, bëjnë diskriminim në mes tyre.

Mu bë njerk. (dikush), nuk dua ta shoh me sy, nuk mund ta duroj, ngaqë më bie në qafë e më mërzit tepër (mu bë) burrë i nënës.

Tek ne thuhet *mduket si mjerk para sojve* që do të thotë më pengon aq shumë sa që më duket si njerk nuk mund që ta duroj, nga që ka bërë diçka të keqe që tash e urrej.

I biri i njerkes, fëmijë i përkëdhelur e i mbajtur mirë, fëmijë i trajtuar ndryshe nga të tjerët.

Gjal i nonës, gjal i mjerkes thuhet kështu sepse ai trajtohet ndryshe nga fëmijët e tjerë sepse njerka atë e lazdron sepse e ka djalë të vetin në krahasim me të tjerët prandaj edhe atë e trajton ndryshe.

Ca të babait ca të njerkut njëri trajtohet mirë e tjetri keq pa të drejtë; ca të nënës e ca të njerkes.

Për njonin bab e për qetrin mjerk, që do të thotë kur babai bën diskriminim në mes të fëmijëve kur njërin e trajton shumë mirë qoftë materialisht qoftë në ndonjë aspekt tjetër, me njërin sillet ashtu siç i takon një prindi të sillet e kurse tjetrin largon gjithmonë nga vetja e vet prandaj edhe thuhet kjo shprehje.

M'u bë njerk - (dikush) nuk dua ta shoh me sy, nuk mund ta duroj, ngaqë më bie më qafë e më mërzit tepër.

I biri njerks - fëmij i përkdhelur e i mbajtur mirë, fëmij I trajtuar ndryshe nga të tjerët; Fëmijë I llastuar. * merreni këtë birrin e njerks e mësojeni si të punojë këtu nuk mbajmë djem mamajesh!

Tek ne thuhet **mduket si mjerk para sojve** që do të thotë më pengon aq shumë sa që më duket si njerk nuk mund që ta duroj, nga që ka bërë diçka të keqe që tash e urrej.

Gjal i nonës, gjal i mjerks thuhet kështu sepse ai trajtohet ndryshe nga fëmijët e tjerë sepse njerka atë e lazdron sepse e ka djalë të vetin në krahasim me të tjerët prandaj edhe atë e trajton ndryshe.

NJERKU

Burri i dytë i një gruaje kundrejt fëmijëve që ka ajo me burrin e parë, burri i nënës. Njerku s'është baba. fj. u.

LIDHJE FAREFISNORE ARTIFICIAL

Farefisni shpirtërore

VËLLA

Vëllau- *puço, pçaj madh, pçaj vogël, abi, lalo, pçaj madh, etj*

VËLLAMËRI (pobratim)

1. Një nga doket e hershme, që kishte për qëllim të forconte miqësinë ndërmjet dy të rinjve a dy burrave, duke pirë një pikë gjak nga njëri-tjetri; lidhja që kishin vëllamët midis tyre, të qenët vëllam me dikë. Vëllamëri e fortë.

Kishte vëllamëri me të.

Emrat përkdhelës dhe thirrjet për respekt të moshës madhore

jengjë – Fjalë nderimi a respekti për femrat e moshës madhore të shtëpisë a të kushërinjve të burrit nga ana e nuses a ndonjë grua e re. Kjo fjalë qëndron në relacion me *efë* për burrat (Lugu i Baranit).

bacalok – përdoret për t'iu drejtuar një njeriu më të moshuar në shenjë respekti, bacës, mixhës (Gjakovë).

efë – kunat, përdorur me kuptimin *efendi, zotëri*. Efa Lleshë(*Zym*). Efa Shyçë (Gorozhup – Prizren).

EMRAT E GRAVE ME EMRIN E BURRIT

Në fushën e terminologjisë familjare, në raportet e burrit me gruan në jetën e tyre bashkëshortore, femrat thirren (thirreshin) me emrin e burrit, ky i fundit i femërorizuar më – ja: *She Memetja, she Islamja* (gruaja e Mehmetit, gruaja e Islamit (*She, Sha* do të jetë shkurtim i brendshëm i turq. *Hanëmshah*“zonjë”, Opojë);

Bardhecja (gruaja e Bardhecit), *Rexhepja* (gruaja e Rexhepit) (Malësia e Gjakovës), *Hasane* (gruaja e Hasanit), *Halime* (gruaja e Halimit) (Dukagjin).

Këto *formime obscene* që lidhen me natyrën sociale a me ndjenjën e turp-it i hasim edhe në zona të tjera, si në atë të Nënshkodrës: *Age Zeffja* (gruaja e Zefit).

Në anën e Rrafshit të Dukagjinit tek emrat familjarë përdoret si mbiemër emri i babës, p. sh. *Jaho*, emri i babës *Salih*, *Jaho Salih*(që vjen si të thuash *Jao, i biri i Salihit*) (Murati Telegrafi 2019).

Në disa rajone të maqedonisë së Veriut, kur bëhet fjalë për raporte të respektit ndaj grave, zakonisht krijohen emërtime të prejardhura. Më shpesh, gratë njihen sipas emrit të burrit, ashtu që u prapngjitet prapashtesa – *vica* e –*ica*. P.sh. *Filevica, Hasanica* etj. dhe kjo formë ka shtrirje më të gjerë përkundër emërtimeve që marrin prapashtesën –*ka*, si: *Eshtrefka, Beharka, Naserka* etj. (Kjo ka shkaktuar që në Patishkë, rajonin e Prilepit, Krushevës etj. të përdoren e të dëgjohen, njëkohësisht të dyja format, edhe me – *vica* e –*ica* edhe me –*ka*).²

ZHARGONE QË LIDHEN EMRAT FAMILJARE

Dy gratë e një burri: *shoqe*

Fëmijët: lulet e jetës

Grua e keqe: *Virane*, Edepsëskë, nursëskë

Gruaja: *ajo*, *cubane*, *pështjellake*,

Muaji i parë i jetës bashkëshortore: Muaji i ëndrrave, *Muaji i mjaltit*

Nata e tretë pas lindjes së foshnjës: *të tretat e natës, tretanet*

Për bashkëshorten: (Pp).e ka me vete prikolicën e ka me vete rimorkion (Lloshi 2001:174);

Raportet familjare midis vëllezërve: “kanë mospajtime dhe janë para ndarjes”, paska hy macja e zezë

² Gj. Shkurtaj, k[to forma t[prejardhura me prapashtes[n –vica i gjen n[t[folme t[Kor][s. Sociolinguistika, Tiran[, 2009, fq.386

EMRA ME PREJARDHJE TË HUAJ

Huazime nga turqishtja

Këto dhe shumë fjalë të tjera, sikurse edhe gjuhët e tjera të Ballkanit, shqipja i ka huazuar nga turqishtja gjatë sundimit 4-5-shekullor të Turqisë në këto anë, ndaj quhen turqizma, edhe pse disa prej tyre turqishtja i ka marrë nga gjuhët e tjera të Lindjes (Orientit), si arabishtja e persishtja (së këtejmi edhe termi tjetër për to: orientalizma). Elementet turke janë më të mëdha në krahasim me huazimet nga gjuhët tjera.

Jashar _Nasteva (2001:87-88) përmend një numër të krahasueshëm leksemash nga kjo fushë. P.sh. *axhë, daja, kainqe, jenge, teze, halla, ane, balldëze, baxhanak, baxho, baba,*

Huazime nga greqishtja

Kontaktet gjuhësore midis shqipes dhe greqishtes të kemi edhe një numër I vogël emrash farefisnor, si p.sh. *kumbar*.

Huazime nga latinishtja

Elementet latine në gjuhën shqipe janë më të shumta në numër, duke i krahasuar me ato të greqishtes së vjetër, të cilat vijnë si rrjedhojë e kontakteve të shpeshta mes dy popullsive. Ky ndikim ka qenë deri rreth fundit të shek. X, sepse më pas fillon huazimi nga italishtja. 14 Meburim latin janë edhe emrat e farefisit : *femër, fëmijë, fqinj, krushk, kunat, kushëri, mashkull, njerë, prind, unjë* etj.; (Doda

Huazime nga sllavishtja

Në gjuhën shqipe kanë depërtuar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe gjatë marrëdhënieve historike me gjuhët sllave të Ballkanit. Këto huazime kanë depërtuar në shqipe pas shek. IX. Midis shumë fushave leksikore të fjalëve sllave janë edhe emrat e lidhjeve farefisnore, si p.sh: *xhaxha, teto, pobratim, zollva* etj.;

**FRAZEOLOGJIZMA ME KOMPONENTË EMRA
FAREFISNORË**

FRAZEOLOGJIZMAT QË LIDHEN ME EMËRTIMET FAMILJARE

Mjaft me rëndësi për të folmet e ndryshme shqipe, paraqesin edhe njësitë frazeologjike që lidhen me komponentë që ka të bëjë me ndonjë emërtim të farefisit. Ne mund të përgjithësojmë në një përkufizim se ç'është njësia frazeologjike dhe të përcaktojmë ç'vend zë ajo ndërmjet njësive themelore të gjuhës?

Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme.

Gjithë togfjalëshat e këtij lloji në gjuhën tonë përbëjnë frazeologjinë shqipe. Nga përcaktimi i konceptit për njësinë frazeologjike varet edhe njohja e vëllimit dhe e kufijve të frazeologjisë gjuhësore në tërësi, ç'përfshin e studion kjo? Po t'i përmbahemi kuptimit tradicional për togfjalëshin, si njësi që përbëhet të paktën nga dy fjalë shënjuese, atëherë nuk do të përfshihen në frazeologjinë gjuhësore të mirëfilltë fjalët e veçanta me kuptim të figurshëm, qoftë edhe kur shoqërohen nga një parafjalë, si: nën dorë, nën rrogoz, nën lëkurë, nën hundë, pa zemër etj.

Formimi i frazeologjisë shqipe si fushë studimi lidhet me dy-tridhjetëvjeçarët e fundit të shek. XX. vëmendja e kërkuesve më parë ishte drejtuar sidomos në mbledhjen e shprehjeve “të rralla e të bukura” nga goja e popullit. Me punën e kujdesin e gjuhëtarëve e të dashamirësve të gjuhës shqipe u arrit të grumbullohej një lëndë e mirë dhe nga fusha e frazeologjisë, e cila u botua nëpër revista e u fut nëpër fjalorë. Që më 1955, me themelimin e kartotekës së leksikut të shqipes, *mbledhjes së frazeologjisë popullore* iu kushtua po ai kujdes si edhe mbledhjes së fjalëve të rralla. Kjo punë u organizua nga sektorë të posaçëm. Frazeologjia e gjuhës sonë ka zënë vend tashmë si një nga objektet kryesore të studimeve leksikologjike dhe po vështrohet nga të gjitha anët dhe me metodat bashkëkohore. Gjithë frazeologjia shqipe, e përgjithshme e dialektore, e gjuhës së shkruar e të folur, është vlerësuar si thesar i çmueshëm i krijuar brez pas brezi nga populli, si një fond i përshtershëm për pasurimin e gjuhës letrare shqipe me njësi kuptimore dhe me mjete shprehëse. Tashti mund të themi se një pjesë e mirë e frazeologjisë shqipe është mbledhur dhe i është nënshtuar botimit e studimit të gjerë. “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999), me rreth 11000 njësi, dëshmon pasurinë e madhe e vlerat e shumanshme të frazeologjisë shqipe. (Thomai 1999).

Frazeologjizmat që lidhen me familjen

I ATI

Atë pas ati, (sh) brez pas brezi.

Si i ati dhe i biri njësoj janë, i kanë ngjarë njëri tjetrit (për dy njerëz) **bëmë baba të të ngjaj.**

Në të folmen urbane të Gostivarit, thuhet **si baba biri**, që do të thotë kur fëmija i ngjan në shumë gjëra prindit, qoftë vepra të mira qoftë për të këqija.

BABAI

Si i ati dhe i biri njësoj janë, i kanë ngjarë njëri tjetrit (për dy njerëz) **bëmë baba të të ngjaj.**

Në të folmen urbane të Gostivarit, thuhet **si baba biri**, që do të thotë kur fëmija i ngjan në shumë gjëra prindit, qoftë vepra të mira qoftë për të këqija.

Bëmë baba të të ngjaj thuhet kur fëmija ngjan shumë me prindin në pamje, në sjellje e në mendime, **si i ati dhe i biri**, hiq e vër atë vetë.

Ja ka kput krajen babës, që do të thotë që fëmija i ka ngjarë babës aq shumë sa që gati janë të njëjtë në çdo gjë në karakter, në mendime, në sjellje etj

Ca të babait ca të njerkut njëri trajtohet mirë e tjetri keq pa të drejtë; ca të nënës e ca të njerkes.

Për njonin bab e për qetrin mjerk, që do të thotë kur babai bën diskriminim në mes të fëmijëve kur njërin e trajton shumë mirë qoftë materialisht qoftë në ndonjë aspekt tjetër, me njërin sillet ashtu siç i takon një prindi të sillet e kurse tjetrin largon gjithmonë nga vetja e vet prandaj edhe thuhet kjo shprehje.

Eja baba të të tregoj arat, (vreshtat) iron.sh.i tregon (I rëfen) babait arat (dikush)iron.

Ai se di për vete e do të më mësoj mua!

Kërkon babën e nanën, kërkon shumë shtrejtë, të rjep.

NËNA

Kërkon babën e nanën, kërkon shumë shtrejtë, të rjep.

Sarafi i dreqit, për një dhi të mer lopën, të kërkon babën e nanën. Kërkon babën e nënën, që do të thotë të ve një çmim të paparashikueshëm një çmim që krahasohet me shpirtin.

Ju bë nënë e baba (dikujt) i qëndroi afër, u kujdes shumë për të, iu bë si prind, sidomos në vështirësi.

Në fshatin tim përdoret kjo shprehje kështu shumë por e afërt me këtë **Ja bo si non e bab**, në të shumtën e rasteve përdoret kur i merr në mbikëqyrje jetimë të kujdeset për to ashtu si prindërit e tyre.

-S'bën nëna (dikë) është shumë i mirë, nuk e ka shokun; nuk i gjendet shoku.

Tek ne thuhet: **s'bon nona qetër ma**, që do të thotë është i pazëvendësueshëm, nuk ka si ai.

Ca të nënës e ca të njerkes nuk shihen të gjithë njëllonj, njëri trajtohet më mirë e tjetri më keq, njërin e duan e tjetrin jo.

Si e ka lindur nëna, lakuriq, i zhveshur.

Tek ne thuhet: **si me dal shtaj pi nonës**, kjo shprehje në të shumtën e rasteve përdoret për vajzat të cilat janë të veshura gati lakuriq, janë shumë të zhveshura.

Edhe sikur nëna të më ngjallet, kurrë!çfarë do që të ndodhë, ehe të më vijë më e mira që mundet të bëhet (për diçka që s'dua ta bëj)

Tek ne përdoret po e njëjta **ene nona me mu ngroj pi vori**, jo që do të thotë kur nuk mund të ndodhë që të bëj diçka që unë nuk dua, që mua nuk më pëlqen ta bëj.

Ështe ritur me dy nëna, thuhet për dikë që ka trup të bëshëm e shëndet të mire

I ka vdekur nëna (diçkaje) ka ngecur keq diçka, është prishur, nuk punon, është punë e mbaruar, plotësisht e sigurt.

I vdiç nona ksaj pune ose **I vdiç nona kti muabeti**, do me thënë që kjo shprehje përdoret për diçka që veç ka marrë fund ka mbaruar e tëra ajo gjë është më se e sigurt.

Gjal i nonës, gjal i mjerkes thuhet kështu sepse ai trajtohet ndryshe nga fëmijët e tjerë sepse njerka atë e lazdron sepse e ka djalë të vetin në krahasim me të tjerët prandaj edhe atë e trajton ndryshe.

DJALI

Gjali babaës ja kallzon mexhet e arës që do të thotë se në qoftë se dikush i tregon dikujt apo e mëson dikë për diçka që ai nuk e din për vete ose kur dikush më i vogël i tregon dikujt më i madh se ai diçka. **E mson voja pulën.**

Na a rejt gjali a bo bur, kur tash më atij nuk i frikohet syri për asgjë, tash nuk frikohet edhe nga prindit dhe prandaj përdoret se është rritur ma d.m.th nuk pyet njeri po as edhe prindërit nuk i dëgjon ato.

Djali pa lerë e djepi blerë, iron. thuhet kur vepron para kohe, peshku në det e tigani në zjarr. për njerëzit e nxituar, që nuk presin radhën a nuk sigurohen më parë për diçka por vepron para kohe.

Gjali pa u li a gjepi a bgji. që do të thotë mos bën hop pa e kërcyer gardhin po çdo gjë shkon me radhë, është po e njëjtë edhe shprehja **peshki ndet e tava nzarm.**

Gjal i nonës, gjal i mjerkës thuhet kështu sepse ai trajtohet ndryshe nga fëmijët e tjerë sepse njerka atë e lazdron sepse e ka djalë të vetin në krahasim me të tjerët prandaj edhe atë e trajton ndryshe.

BURRË

U bë burrë, (dikush u rrit), u burrërua, ra në bylyk. Mori guxim dhe trimërohet, nuk trembet më; mori zemër.

Na a rejt gjali a bo bur, kur tash më atij nuk i frikohet syri për asgjë, tash nuk frikohet edhe nga prindit dhe prandaj përdoret se është rritur ma d.m.th nuk pyet njeri po as edhe prindërit nuk i dëgjon ato.

Burr i dheut, njeri i zoti me karakter të fort (edhe si thirror).

Bur i rond, që do të thotë (burrë i rëndë) njeri i ndershëm, njeri i fjalës, trim dhe i fortë.

S'ka burrë (nane) s'ka njeri të lindur që t'ia dalë në krye një punë e që ti dalë përpara dikujt. Tek ne përdoren dy shprehje por me të njëjtin kuptim **s'ka bur none** dhe **s'ka bir none**, që do të thotë nuk mund të jetë dikush më i fortë se unë po nëse don të provoj forcën le të më del ballë.

Bëhet burri i mirë në sofër të huaj, thuhet për një njeri të keq që i fut hundët ku nuk i takon. që bën nderë me nderin dhe të mirën e të tjerëve.

Mbahet bur i majr nshpaj tqetër kujt, thuhet për një njeri të ligë që bën vetë keq dhe përzihet në punët e huja në shtëpi të tjetër kujt i fut hundët aty ku s'duhet.

Është bur ding, është me të gjitha cilësitë e mira njeri i fortë, trim e bujar. S'ka çka i thua është burrë ding.

Në fshatin tonë përdoret **është bur e xhims**, kur është njeri me të gjitha të mirat, burrë i fort, i ndershëm i sjellshëm, burrë i fjalës. **xhi di thaujish bur e xhims osht.**

Burrin e kallëzon besa, njeriun e fortë dhe trim e tregon fjala e dhënë. burrin e kallëzon besa.

Bur osht aj xhi e mban llafin, thuhet tek ne kështu për atë arsye se fjala e dhënë është virtyti më i rëndësishëm për një burrë dhe ves për të gjithë Shqiptarët sepse dihet që burri nuk duhet të luaj prej fjalës që e ka dhënë.

Burri me kosh e gruja me lugë, thuhet për një shtëpi që nuk ka harmoni ku shpërdorohet pa masë.

E ka burrërinë në këmbët e veta, është tamam burrë me të gjitha cilësitë e burrit.

BIRI

Djali me të birin, të gjithë pa dallim, edhe ata që duhen edhe ato që nuk duhen.

Tek ne përdoret një shprehje tjetër po që e ka kuptimin e njëjtë me këtë. ajo frazë është:

FËMIJË

Dridhet fëmija në barkun e nënës (sh) dridhet foshnja në barkun e nënës. kur ka frik për diçka është duke ndodhur diçka që dridhet edhe fëmija në bark.

Dridhet ene caulli nbarkin e nonës.

Me fëmijë e (me) rropulli me të gjithë e me gjitha ç'ka shtëpia; me njerëz e me çdo gjë; me laçka e me plaçka.

CAULL

Me caull e me maull, që do të thotë krejt sa ishin, të gjithë që janë në shtëpi, si p.sh. *Na kan ardh ndarsëm ma caull e me maull.*

Cullë e mullë (me cullë e me mullë) Krahinë. I madh e i vogël, të gjithë * e këshilloj të aratisej me cullë e me mullë .

SHTOJCA

ANKETIMI I EMRAVE FAMILJARË

TË DHËNA TË NEVOJSHME PËR ‘PASAPORTIZIMIN ‘ E MATERIALIT

Emri dhe mbiemri i personit që pyetet	<p>Armend Shabani (Dobërdoll – Gostivar, nxënës, 19 vjeç Fatmire Asani (Pershefcë –Tetovë, të lartë, 25 vjeçe) Mevlana Jakupi (Shipkovicë –Tetovë, të mesme, 20 vjeçe) Lazime Mehazi (Veshallë –Tetovë, fillore, 45 vjeçe) Leila Emini (Leshnicë-Zhelinë,nxënëse18 vjeçe) Egzona Idrizi (Zhelinë-Tearcë,,studente, 20 vjeçe) Emine Salihi (Odri –Tearcë ulet ,47 vjeçe); Huriye Salihi (Sllatinë-Teracë ulet 47vjeçe), Imer Imeri (Neproshten –Teracë,arsim te larte ,52); Haxhere Sadiki (Pershefcë –Tetovë ,ulet 41 vjeçe) Valmira Idrizi (Poroj –Tetovë,larte 30); Safije Shaqiri(Orash-Vratnicë ulet ,63vjeçe) Muhabere Zendeli (Neproshten –Tearcë) Mersije Jahjai (Kamijan –Bogovinë lart ,38 vjeçe)</p>
Anketuesi	<p>Fatlume Shabani (Dobërdoll – Gostivar, 2015); Fekrije Sadiki (Pershefcë –Tetovë, 2014); Lavdona Amzai (Shipkovicë –Tetovë, 2015); Shukri Bexheti (Veshallë –Tetovë) Suada Memeti (Leshnice Zhelinë 2015) Zoga Papraniku (Ballance –Diber Jetlira Imeri (Zheline 2019) Jetlira Imeri (Odri 2019 Jetlira Imeri (Sllatinë-Teracë 2019) Jetlira Imeri (Neproshten –Tearcë 2019) Jetlira Imeri (Pershefcë –Tearcë 2019) Jetlira Imeri (Poroj –Tearcë 2019 Jetlira Imeri (Orash-Vratnicë –Tearcë 2019 Jetlira Imeri(Neproshten –Tearcë 2019) Jetlira Imeri (Kamijan –Bogovinë 2019)</p>

1.	Trajatat e dyta të emrave të përveçëm (Zbunimi dhe nofkat)	
2	Si e ke emrin e plotë?	<p>Armend (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire (Pershefcë-Tetovë) Mevlana (Shipkovicë-Tetovë) Lazime (Veshallë–Tetovë) Lejla (Leshnicë-Zhelinë) Gramoz (Ballance-Diber) Egzona (Zhelinë)</p>

		Emine (Odri-Tearcë) Hurije (Sllatinë–Tearcë) Imer (Neproshten -Tearcë) Haxhere (Pershefcë-Tetovë) Valmira (Poroj-Tetovë) Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere (Neproshten-Tetovë) Mersije (Kamijan–Bogovinë)
2.1	Si të thërret nëna jote?	Armend>Mendi (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire>Fate (Pershefcë-Tetovë) Mevlana>Lanushi (Shipkovicë–Tetovë) Shukri>Shuko (Veshallë–Tetovë) Leila>Leli (Leshnicë-Zhelinë) Gramos>Moska (Ballance-Diber) Egzona >Xona (Zhelinë) Emine >Mine (Odri-Tearcë) Hurije >Hurka (Sllatinë–Tearcë) Imer>Imer (Neproshten-Tearcë) Haxhere>Haxher (Pershefcë-Tetovë) Valmira>Mile (Poroj-Tetovë) Safije>Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere>Bele(Neproshten-Tetovë) Mersije>Mersa(Kamijan –Bogovinë)
Mersije	Si të thërret babai yt?	Armend>Mendi (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire>Fatka(Pershefcë--Tetovë) Mevlana>Lana(Shipkovicë –Tetovë) Shukri>Shuko (Veshallë–Tetovë) Leila>Lela(Leshnicë-Zhelinë) Gramoz>Moska((Ballance-Diber)) Egzona>Xona(Zhelinë) Emine >Mine Odri-Tearcë) Hurije>Hurka (Sllatinë–Tearcë) Imer>Imer (Neproshten-Tearcë) Haxhere>Haxher (Pershefcë-Tetovë) Valmira>Mile (Poroj-Tetovë) Safije>Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere >Bele (Neproshten-Tetovë) Mersije >Mersa (Kamijan –Bogovinë)
2.3	Si të thërret motra jote?	Armend>Mendi (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire>Mira (Pershefcë-Tetovë) ; Mevlana>Lana (Shipkovicë–Tetovë) Shukri>Shuki (Veshallë–Tetovë) Leila>Leli (Leshnicë-Zhelinë) Gramos>Moska (Ballance-Diber) ,Emine >Mine(Odri-Tearcë) Hurije>Hije(Sllatinë–Tearcë) Imer>Imer (Neproshten -Tearcë) Haxher >Haxhere (Pershefcë -Tetovë) Valmira>Mile (Poroj-Tetovë) Safije>Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere>Bele (Neproshten-Tetovë)

		Mersije >Mersa (Kamijan–Bogovinë)
2.4	Si të thërret vëllai yt?	Armend>Mendi (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire>Mira (Pershefcë-Tetovë) Mevlana>Lanushi(Shipkovicë–Tetovë) Shukri>Shuki (Veshallë –Tetovë) Gramoz>Moska (Ballance-Diber) Egzona>Xona (Zhelinë) Emine>Mine(Odri-Tearcë) Huriye>Hije>(Sllatinë–Tearcë) Haxher >Haxher(Pershefcë-Tetovë) Valmira>Mile (Poroj-Tetovë) Safije>Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere>Bele (Neproshten-Tetovë) Mersije >Mersa (Kamijan –Bogovinë)
2.5	Si të thërrasin shoqet e shokët?	Armend>Mendi (Dobërdoll-Gostivar) Fatmire>Mira>Fete (Pershefcë-Tetovë) Mevlana>Lanushi (Shipkovicë–Tetovë) Shukri>Shuki (Veshallë–Tetovë) Leila>Leli (Leshnicë-Zhelinë) Gramoz>Moska (Ballance-Diber) Egzona>Xona (Zhelinë) Emine>Mine (Odri-Tearcë) Huriye>Hurka (Sllatinë–Tearcë) Imer >Gazda (Neproshten-Tearcë) Haxher>Xhele (Pershefcë-Tetovë); Safije>Safije (Orash-Vratnicë) Muhabere>Bele (Neproshten-Tetovë) Mersije >Mersa (Kamijan –Bogovinë)
2.6	A ke ndonjë nofkë?	
3.	Si e ka emrin e plotë nëna jote :	Agime (Dobërdoll-Gostivar) Syzana (Pershefcë-Tetovë) Mirsada (Shipkovicë–Tetovë) Hatije (Veshallë–Tetovë) Mirsade (Leshnicë-Zhelinë) Lindita (Ballance-Dibër) Semijal (Zhelinë) Hamide (Odri-Tearcë) Hirijet (Sllatinë-Teracë) Fetije (Neproshten-Tearcë) Muhabër (Pershefcë-Tetovë) Sadbere (Poroj–Tetovë) Hatixhe (Orash-Vratnicë) Zulije (Neproshten- Tetovë) Nadije (Kamijan–Bogovinë)
3.1	Si e thërret ti?	nani (Dobërdoll-Gostivar) nane (Pershefcë-Tetovë) mami (Shipkovicë–Tetovë) non (Veshallë–Tetovë) mami (Leshnicë-Zhelinë) mami (Ballance-Dibër) nani (Zhelinë)

		<p>nan (Odri-Tearcë) nan (Sllatinë–Tearcë) nan (Neproshten-Tearcë) nan (Pershefcë-Tetovë) nan(Poroj –Tetovë) nan(Orash-Vratnicë) nan (Neproshten-Tetovë) nono)Kamijan–Bogovinë)</p>
3.2	Si e thërret babai yt?	<p>Gimo (Dobërdoll-Gostivar) Zanush (Pershefcë-Tetovë) oj grue (Shipkovice–Tetovë) Hato (Veshallë–Tetovë) oj grue (Leshnicë-Zhelinë) Dita (Ballance-Dibër) Male (Zhelinë) oj grue (Odri-Tearcë) oj taj (Sllatinë–Tearcë) oj taj(Neproshten-Tearcë) oj taj (Pershefcë-Tetovë) oj taj (Poroj–Tetovë) Hatixhe (Orash-Vratnicë) o njeri (Neproshten- Tetovë) Nadije Kamijan –Bogovinë)</p>
3.3	Si e thërret motra jote?	<p>Nanul (Dobërdoll-Gostivar) syzeze (Pershefcë-Tetovë) oj na (Shipkovice –Tetovë) Shuki (Veshallë–Tetovë) oj na (Leshnicë-Zhelinë) mami (Ballance-Dibër) nan (Odri-Tearcë) nan (Sllatinë–Tearcë) nan(Neproshten -Tearcë) nan(Pershefcë -Tetovë) nan(Poroj–Tetovë) nan (Orash-Vratnicë) nan (Neproshten- Tetovë)</p>
3.4	Si e thërret vëllai yt	<p>Lanushi (Shipkovice–Tetovë) nan (Veshallë–Tetovë) nani (Zhelinë) nan (Odri-Tearcë) nan (Sllatinë–Tearcë) nan (Pershefcë-Tetovë) nan (Poroj–Tetovë) nan(Orash-Vratnicë) nan(Neproshten-Tetovë) nono (Kamijan–Bogovinë)</p>
3.5	Si e thërrasin farefisi i saj	<p>Shuki (Veshallë–Tetovë) Cade(Leshnicë-Zhelinë) Dita (Ballance-Dibër) Semijal(Zhelinë) Nafica (Odri-Tearcë)</p>

		Hirijet ,dad (Sllatinë–Tearcë) Aba lule (Neproshten -Tearcë); Musavajc (Pershefcë-Tetovë) Nause ,Kadravajca (Poroj–Tetovë) Dada Tixhe (Orash-Vratnicë) Zulije (Neproshten- Tetovë) Dushe (Kamijan –Bogovinë)
3.6	A ka ndonjë nofkë	
4.	Si e ka emrin e plotë babai yt?	Qesmer (Dobërdoll-Gostivar) Hajredin (Pershefcë-Tetovë) Milazim (Shipkovice–Tetovë) Ismail (Veshallë –Tetovë) Bedri (Leshnicë-Zhelinë) Iilir (Ballance-Dibër) Dashmir (Zhelinë) Nafi (Odri-Tearcë) Arif (Sllatinë–Tearcë) Zeqir (Neproshten-Tearcë) Musa (Pershefcë-Tetovë) Abdykadro (Poroj–Tetovë) Haqif (Orash-Vratnicë) Havzi (Neproshten-Tetovë) Shaban (Kamijan–Bogovinë)
4.1	Si e thërret ti?	babi (Dobërdoll-Gostivar) babi (Pershefcë -Tetovë) babi (Shipkovice–Tetovë) bushi (Veshallë–Tetovë) babi (Leshnicë-Zhelinë) babi (Ballance-Dibër) babi (Zhelinë) haxhi agi (Odri-Tearcë) ata (Sllatinë–Tearcë) babi i ri (Neproshten-Tearcë) babi (Pershefcë-Tetovë) babi (Poroj–Tetovë) bab (Orash-Vratnicë) babi (Neproshten-Tetovë) babi (Kamijan–Bogovinë)
4.2	Si e thërret nëna jote?	ceco (Dobërdoll-Gostivar) Hajro (Pershefcë-Tetovë) o burri (Shipkovice-Tetovë) Ismael (Veshallë–Tetovë) o burri (Leshnicë-Zhelinë) Lili (Ballance-Dibër) Dashmir,Mili (Zhelinë) o taj (Odri-Tearcë) or taj (Sllatinë–Tearcë) o taj (Neproshten-Tearcë) Musa (Pershefcë-Tetovë) o taj (Poroj–Tetovë) o taj (Orash-Vratnicë)

		Havzi (Neproshten-Tetovë) Shaban (Kamijan –Bogovinë)
4.3	Si e thërret motra jote?	babi (Dobërdoll-Gostivar) Redi (Pershefcë-Tetovë) o babush (Shipkovice –Tetovë); babushi (Veshallë –Tetovë) babush (Leshnicë-Zhelinë) babi (Ballance-Dibër) haxhi agi (Odri-Tearcë) ata (Sllatinë –Tearcë) babi i ri (Neproshten -Tearcë) babi (Pershefcë -Tetovë) babi (Poroj–Tetovë) bab (Orash-Vratnicë) babi (Neproshten- Tetovë)
4.4	Si e thërret vëllai yt?	babi (Shipkovice–Tetovë) babushi (Veshallë–Tetovë) babi (Ballance-Dibër) babi (Pershefcë-Tetovë) haxhi agi (Odri-Tearcë) ata (Sllatinë–Tearcë) babi (Pershefcë-Tetovë) babi (Poroj –Tetovë) bab (Orash-Vratnicë) babi (Neproshten-Tetovë) babi (Kamijan –Bogovinë)
4.5	Si e thërrasin farefisi dhe shokët e tij?	Qeco,qeco (Dobërdol-Gostivar) Hajredin,Hajro,Redi.Dini (Pershefcë-Tetovë) Cade (Shipkovice –Tetovë) Mejlo (Veshallë–Tetovë) Bedri (Leshnicë-Zhelinë) Lili (Ballance-Dibër) bufi (Zhelinë) haxhi Nafia,baba minës (Odri-Tearcë) Api Arif (Sllatinë –Tearcë); Zeqiri (Neproshten –Tearcë) Musa (Pershefcë -Tetovë); Kadri (Poroj –Tetovë) Lala haqif (Orash-Vratnicë); Havzi (Neproshten- Tetovë) shaci (Kamijan –Bogovinë)
	A ka ndonjë nofkë /me përkëdhelje?	Malo (Veshallë –Tetovë)
5.	Si e ka emrin e plotë gjyshi yt?	Abdylbesir (Dobërdoll-Gostivar) Irfan (Pershefcë -Tetovë) Shemsedin (Shipkovice–Tetovë) Balok (Veshallë–Tetovë) Muhamed (Leshnicë-Zhelinë) Xhevat (Ballance-Dibër) Demerali (Zhelinë) Adem (Odri-Tearcë) Tefik (Sllatin–Tearcë)

		<p>Xheladin (Neproshten-Tearcë) Adem (Pershefcë-Tetovë) Rexhep (Poroj–Tetovë) Latif (Orash-Vratnicë) Zelfi (Neproshten-Tetovë) Abdylvait (Kamijan –Bogovinë)</p>
5.1	Si e thërret ti?	<p>baba Besir (Dobërdoll - Gostivar) baba (Shipkovicë–Tetovë) o ago (Pershefcë-Tetovë) balok (Veshallë–Tetovë) o ago (Leshnicë-Zhelinë) gjishi (Ballance-Dibër) ago (Zhelinë) babush (Odri-Tearcë) babush (Sllatinë –Tearcë) ata(Neproshten-Tearcë) aga(Pershefcë -Tetovë) baba Rexhep (Poroj –Tetovë) baba plak(Orash-Vratnicë) ago (Neproshten- Tetovë) baba (Kamijan –Bogovinë)</p>
5.2	Si e thërret nëna jote?	<p>babo balok(Dobërdoll-Gostivar) baba (Shipkovicë–Tetovë) o ago (Pershefcë-Tetovë) baba (Veshallë–Tetovë) o ago(Leshnicë-Zhelinë) baba (Ballance-Dibër) haxhi aga (Zhelinë) ata(Odri-Tearcë) ata (Neproshten-Tearcë) bab (Pershefcë-Tetovë) baba Rexhep (Poroj–Tetovë) babo(Orash-Vratnicë) babo (Neproshten-Tetovë) babo(Kamijan –Bogovinë)</p>
5.3	Si e thërret motra jote?	<p>baba Besir (Dobërdoll-Gostivar) babushi (Shipkovicë –Tetovë) o ago (Pershefcë -Tetovë) balok (Veshallë–Tetovë) o ago (Leshnicë-Zhelinë) gjishi (Ballance-Dibër) babush (Odri-Tearcë) babush(Sllatinë–Tearcë) ata(Neproshten-Tearcë) aga(Pershefcë-Tetovë) baba Rexhep (Poroj–Tetovë) baba plak (Orash-Vratnicë) ago (Neproshten- Tearcë)</p>
5.4	Si e thërret vëllai yt	<p>bab(Dobërdoll-Gostivar) balok (Veshallë–Tetovë) gjishi (Ballance-Dibër)</p>

		ago (Zhelinë) babush (Odri-Tearcë) babush (Sllatinë–Tearcë) aga (Pershefcë–Tetovë) baba Rexhep (Poroj–Tetovë) baba plak (Orash-Vratnicë) ago (Neproshten- Tetovë) babo (Kamijan –Bogovinë)
5.5	Si e thërrasin farefisi dhe shokët e tij?	Besir (Dobërdoll-Gostivar) Irfan ,Fana (Pershefcë -Tetovë) Shemso (Shipkovice–Tetovë) Lalo (Veshallë–Tetovë) Meti (Leshnicë-Zhelinë) Xhati (Ballance-Dibër) Haxhi (Zhelinë(Poroj–Tetovë) Adem (Odri-Tearcë) Haxhi Tefiki (Sllatinë–Tearcë) ata (Neproshten -Tearcë) Adem (Pershefcë -Tetovë) Xhepa Poroj –Tetovë) Lala Latif (Orash-Vratnicë) Puci Zelfi (Neproshten- Tetovë) Puca Abdylvait (Kamijan –Bogovinë)
5.6	A ka ndonjë nofkë?	
6	Si e ka emrin e plotë gjithë jote	Remzo (Dobërdoll-Gostivar) Selvie (Pershefcë–Tetovë) Shemie (Shipkovice–Tetovë) Shahine (Veshallë –Tetovë) Rukije (Leshnicë-Zhelinë) Lirije (Ballance-Dibër) Haxhere (Zhelinë) Behare (Odri-Tearcë) Zinepe (Sllatinë–Tearcë) Samije (Neproshten-Tearcë) Gjilsha (Pershefcë -Tetovë) Rivajet (Poroj–Tetovë) Xhemile (Orash-Vratnicë). Shahe (Neproshten- Tetovë) Sherete (Kamijan –Bogovinë)
6.1	Si e thërret ti?	nana babil (Dobërdoll-Gostivar) gjyshe (Pershefcë-Tetovë) oj nuce (Shipkovice–Tetovë) Shahine (Veshallë–Tetovë) oj nuce (Leshnicë-Zhelinë) Gjishe (Ballance-Dibër) nuce (Zhelinë) nana agit (Odri-Tearcë) nuce (Sllatinë–Tearcë) xhishe (Neproshten-Tearcë) nana babil (Pershefcë -Tetovë) nana dsjxhes (Poroj –Tetovë)

		<p>Paka (Orash-Vratnicë) Nana dsjxhes (Neproshten-Tetovë) njene (Kamijan –Bogovinë)</p>
6.2	Si e thërret babai yt?	<p>nene (Dobërdoll - Gostivar) gjyshe(Pershefcë -Tetovë) oj na (Shipkovice –Tetovë); gjyshja plake(Veshallë –Tetovë) oj nuce (Leshnicë-Zhelinë) ane (Ballance-Dibër) Hxhica (Zhelinë) nan (Odri-Tearcë) nuce (Sllatinë–Tearcë) xhishe(Neproshten -Tearcë) nan(Pershefcë-Tetovë) xhishe (Poroj–Tetovë) Paka(Orash-Vratnicë) Xhishe (Neproshten- Tetovë) Njene (Kamijan –Bogovinë)</p>
6.3	Si e thërret motra jote?	<p>Honkonene (Dobërdoll-Gostivar) gjyshja plake(Veshallë–Tetovë) oj nuce (Leshnicë-Zhelinë) nana (Ballance-Dibër) nuce(Zhelinë) nana agit (Odri-Tearcë) nuce (Sllatinë–Tearcë) xhishe (Neproshten-Tearcë) nana babit (Pershefcë-Tetovë) nana dajxhes (Poroj –Tetovë) Paka (Orash-Vratnicë) nana dsjxhes (Neproshten-Tetovë)</p>
6.4	Si e thërret vëllai yt	<p>oj nuce(Shipkovice –Tetovë) gjyshja plake (Veshallë–Tetovë) gjishe (Ballance-Dibër) nana agit (Odri-Tearcë) nuce (Sllatinë –Tearcë) nana babit(Pershefcë-Tetovë) nana dajxhes (Poroj–Tetovë) Paka(Orash-Vratnicë) nana dsjxhes (Neproshten-Tetovë) njene(Kamijan –Bogovinë)</p>
6.5	Si e thërrasin fërfësi i saj	<p>Remzo (Dobërdoll - Gostivar) Selvie ,Selvo ,Vie(Pershefcë -Tetovë) Abo (Shipkovice –Tetovë) Lalo (Veshallë –Tetovë) Lirije (Ballance-Dibër) Demeralica (Zhelinë) Nepe,nuce (Sllatinë–Tearcë); Samije (Neproshten-Tearcë)</p>

		Ademica (Pershefcë -Tetovë) Avzije (Poroj –Tetovë) Nausja lalës latif (Orash-Vratnicë) Nausja las refik (Neproshten- Tetovë) njene (Kamijan –Bogovinë)
6.6.	A ka ndonjë nofkë	
7.	Si e ka emrin e plotë gjyshi yt	Halit (Dobërdoll-Gostivar) Sali (Veshallë–Tetovë) Sheip (Shipkovice –Tetovë) Bexhet (Veshallë–Tetovë) Arif (Leshnicë-Zhelinë) Sami (Ballance-Dibër) Zija (Zhelinë) Isni (Odri-Tearcë) Memet (Sllatinë–Tearcë) Mustafa (Neproshten-Tearcë) Ramadan (Pershefcë -Tetovë) Avzi (Poroj –Tetovë) Shaban (Orash-Vratnicë) Refik (Neproshten- Tetovë) Servet (Kamijan –Bogovinë)
	Si e thërret ti?	baba Lit (Dobërdoll - Gostivar) gjyshi (Pershefcë -Tetovë) o bab (Shipkovice –Tetovë) baba gjysh (Veshallë–Tetovë) O ago (Leshnicë-Zhelinë) babi (Ballance-Dibër) babo (Zhelinë) baba xhish (Odri-Tearcë) lal (Sllatinë –Tearcë) ata (Neproshten -Tearcë) baba xhish (Pershefcë -Tetovë) ata (Poroj –Tetovë) baab xhish (Orash-Vratnicë) baba dajxhes (Neproshten- Tetovë) baba dajxhes (Kamijan –Bogovinë)
	Si e thërret nëna jote?	lito (Dobërdoll - Gostivar) baba (Pershefcë -Tetovë) obabo (Shipkovice –Tetovë) bab (Veshallë–Tetovë); o babo (Leshnicë-Zhelinë) baba (Ballance-Dibër) b abo (Zhelinë) haxhi baba (Odri-Tearcë); lal (Sllatinë –Tearcë) ata (Neproshten -Tearcë); at (Pershefcë -Tetovë); at (Poroj –Tetovë) bab (Orash-Vratnicë) baba (Neproshten- Tetovë) baba met (Kamijan –Bogovinë)

	Si e thërret motra jote?	baba Lito (Dobërdoll-Gostivar) bab (Shipkov;ice–Tetovë) baba gjysh (Veshallë–Tetovë) o ago (Leshnicë-Zhelinë) baba (Ballance-Dibër) Lal (Sllatinë–Tearcë); ata (Neproshten-Tearcë) baba xhish (Pershefcë-Tetovë) ata (Poroj–Tetovë) baba xhish (Orash-Vratnicë) baba dajxhes (Neproshten- Tetovë)
	Si e thërret vëllai yt	Sali ,Lia (Pershefcë -Tetovë) o babo (Shipkovicë–Tetovë) baba gjysh (Veshallë –Tetovë) baba (Ballance-Dibër) babo (Zhelinë) baba xhish (Odri-Tearcë) Lal (Sllatinë–Tearcë) (Neproshten -Tearcë); baba xhish (Pershefcë -Tetovë); ata (Poroj –Tetovë) baba xhish (Orash-Vratnicë) baba dajxhes (Neproshten- Tetovë) baba dajxhes (Kamijan –Bogovinë)
	Si e thërrasin farefisi dhe shokët e tij?	Halit,Lito (Dobërdoll-Gostivar) La (Shipkovicë–Tetovë) Xheto (Veshallë–Tetovë) Arif (Leshnicë-Zhelinë) Sami (Ballance-Dibër) Xaja Zhelinë) Lala isni (Odri-Tearcë) Tafa (Neproshten-Tearcë) Dani (Pershefcë-Tetovë) Avzi (Poroj–Tetovë) Lala Shaban (Orash-Vratnicë) Msusi Refik (Neproshten- Tetovë) Meti (Kamijan –Bogovinë)
	A ka ndonjë nofkë?	Xheto (Veshallë –Tetovë) Lal (Sllatinë –Tearcë);
	8. Si e ka emrin e plotë gjithjshja jote?	Rufije (Dobërdoll - Gostivar) Feride (Pershefcë -Tetovë) Zemrije (Shipkovicë–Tetovë) Selvishahe (Veshallë –Tetovë); Rabije (Leshnicë-Zhelinë) Igballe (Ballance-Dibër) Ruhide (Zhelinë) Hirisha (Odri-Tearcë) Atifete (Sllatinë–Tearcë) Hafize (Neproshten-Tearcë) Nurije (Pershefcë -Tetovë) Mirvet (Poroj –Tetovë) Sadbere (Orash-Vratnicë)

		Revije (Neproshten- Tetovë)
	Si e thërret ti?	gena e dajxhes (Dobërdoll - Gostivar) gjyshe (Pershefcë -Tetovë) oj nan (Shipkovice –Tetovë) gjyshe (Veshallë –Tetovë) oj nuce (Leshnicë-Zhelinë) nana (Ballance-Dibër) nana letkes Zhelinë) xhishe (Odri-Tearcë) nana mijës (Sllatinë–Tearcë) nan (Neproshten -Tearcë); xhishe (Pershefcë -Tetovë); nanoje (Poroj –Tetovë) xhishe (Orash-Vratnicë); nagi (Neproshten- Tetovë) nana dajxhes (Kamijan –Bogovinë)
	Si e thërret babai yt?	xhishe (Dobërdoll-Gostivar) gjyshe (Pershefcë-Tetovë) xhishe (Shipkovice–Tetovë) xhishe (Veshallë–Tetovë) xhixhe (Leshnicë-Zhelinë) Bale (Ballance-Dibër) nausja pucës Zija Zhelinë) xhishe (Odri-Tearcë); Xhishe (Sllatinë–Tearcë) xhishe (Neproshten -Tearcë); xhishe (Pershefcë –Tetovë nan (Poroj –Tetovë) xhishe (Orash-Vratnicë) nagi (Neproshten- Tetovë) nana dajxhes (Kamijan –Bogovinë)
	Si e thërret nena jote ?	nen (Dobërdoll - Gostivar); nane (Pershefcë -Tetovë); oj na (Shipkovice –Tetovë); Selvo (Veshallë –Tetovë); oj nano (Leshnicë-Zhelinë) xhixhe (Ballance-Dibër) nana letkes Zhelinë) nan (Odri-Tearcë); nana mijës (Sllatinë–Tearcë) oj taj (Neproshten -Tearcë) xhishe (Pershefcë -Tetovë) nanoje (Poroj–Tetovë) xhishe (Orash-Vratnicë) nagi (Neproshten-Tetovë) nana dajxhes (Kamijan –Bogovinë)
N	Si e thërret motra yte?	nëno (Dobërdoll-Gostivar) oj nan (Shipkovice–Tetovë) gjyshe (Veshallë –Tetovë) nana (Ballance-Dibër) xhishe (Odri-Tearcë)

		<p>nanmijës (Sllatinë–Tearcë) xhishe (Pershefcë -Tetovë) nanoje(Poroj –Tetovë) xhishe (Orash-Vratnicë) nagi (Neproshten- Tetovë)</p>
	Si e thërret vëllai yte?	<p>oj nan (Shipkovice –Tetovë) gjyshe(Veshallë –Tetovë) nana (Ballance-Dibër) nana letkes (Zhelinë) xhishe (Odri-Tearcë); nanamijës(Sllatinë-Tearcë); xhishe(Neproshten -Tearcë); xhishe (Pershefcë -Tetovë); nanoje (Poroj –Tetovë) xhishe(Orash-Vratnicë) nagi (Neproshten- Tetovë) nana dajxhes (Kamijan –Bogovinë)</p>
	Si e thërrasin fërefisi i saj	<p>Rufko(Dobërdoll - Gostivar); Ide(Pershefcë -Tetovë); Abuce(Shipkovice –Tetovë); Selvo(Veshallë –Tetovë); Rabije (Leshnicë-Zhelinë) Bale (Ballance-Dibër) sheqer nausja (Zhelinë) Shae (Odri-Tearcë); nausja apës met (Sllatinë –Tearcë); Tafavajc (Neproshten -Tearcë) ;Ramadanajca(Pershefcë-Tetovë) Pake(Orash-Vratnicë) Nagi(Neproshten- Tetovë) njene (Kamijan –Bogovinë)</p>

FJALOR

A

áb(ë)ll,~a *f.* Kështu i quan nusja të afërmit e burrit në shenjë nderimi. P.sh. *Ablla Nedime. Ablla Xhemile.* (Cër.) (Ibrahimi 2007:40).

ab,-a *f.* 1. gruaja e dytë e babait (Tetovë); 2. motra e madhe (Prilep ,Dibër ,Tetovë)

ab/ëll-lla, *f.* motra e madhe (Prilep Tetovë)

ába *f. përk.* Emër përkëdhelës me të cilin fëmijët a të rinjtë i drejtohen motrës më të madhe me dashuri e nderim. P.sh. *Me abën di b^uojm paunët.* (P.,K.). (Ibrahimi 2007:40).

abalule *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

abaqe- motra e babit (Gostivar, Tetovë)

abi *m.* Vëllai i madh (Tetovë, Prilep)

abi efendi - emërtimet sinonimike nga nusja, për vllain (kunatin) e madh të burrit (Selmani 2016:105)

abi efendi *m.* kunati (Gostivar)

ablla e madhe *tf.* motra e madhe (Tetovë)

abushja *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

acik karanfil zollva - emërtimet sinonimike nga nusja, për motrën e burrit (Selmani 2016:105)

açik karanfilçe - emërtimet sinonimike nga nusja, për motrën e burrit (Selmani 2016:105)

acik, bajrak dilber aga- emërtimet sinonimike nga nusja, për vllain (kunatin) e vogël të burrit (Selmani 2016:105)

adásh,~i *m.sh. ~ët.* emnak. (P.,K.) (Ibrahimi 2007:40).

ag,-a *f.* i ati, babai *f.* (Tetovë)

ág/e,~ja *f.* Shprehje përkëdhelëse për babanë. (Cër.). (Ibrahimi 2007:40).

ag/e,-ja *f.* i ati, babai (Prilep)

aga puc *tf.* vëllai i madh (Tetovë)

agë – *Aga Met (Mehmet, në anë të Gjilanit, nën ndikimin e turqishtes).*

agobába *f.* Emër me të cilin e reja e thërret vjehrrin, babai i djalit. P.sh. *O e broj kush na garkoj / baba xhypi na garkoj/ agobaba na shkarkoj.* (Ibrahimi 2003:108) (Cër.). (Ibrahimi 2007:41).

akikat qibar zollva - emërtimet sinonimike nga nusja, për motrën e burrit (Selmani 2016:105)

allallzáde *ndajf.* Grua e mirë. P.sh. *Du d'gje ni grue allallzade.* (Cër.) (Ibrahimi 2007:42).

alltën aba *f.* vjehrrën (Gostivar)

alluçk,-a *f.* halla në formë përkëdhelëse (Prilep)

an/e, ja *f.* e ëma, nëna (Tetovë, Prilep)

anë-ja *f.* plake e moçme (Myzeqesë)

ánko,~ja *f.sh. ~t.* 1. Thuhet për grua plakë. 2. *ndajf.* Lojë fëmijësh. P.sh. *Ai da bredhim anko.* (Cër., Allld); **kúkull** (K.). (Ibrahimi 2007:44).

ap/e,-ja *f.* stërgjyshi (Tetovë)

ápo,~ja *f. përk.* Emër përkëdhelës me të cilin fëmijët a të rinjtë i drejtohen vëllait më të madh me dashuri e nderim. P.sh. *Erdhi apoja pi ke selishtja?* (K.,P.). (Ibrahimi 2007:44); 2. stërgjyshi (Tetovë); 3. i ati, babai (Strugë toskë)

axha xhaxhi (Dibër, Tetovë)

axha vogël a.f. ,xhaxhai (Tetovë)

axhamái *ndajf.* Djalë ose vajzë në moshë të vogël, çilimi. P.sh. *Nema axhamai osh.* (P.,K.). (Ibrahimi 2007:46).

axhe *m* xhaxhai (Strugë gegë)

axhi *m* xhaxhai (Strugë toskë)

axhíc,~a *f.sh. ~ët.* 1. Shoqja a gruaja e Haxhiut. 2. *fig.* Grua tepër e moralshme. P.sh. *Mos u bon axhíc* (P.,K.). (Ibrahimi 2007:46).

axhush *m.* xhaxhai (Tetovë)

axhúxh/e,~ja *f.sh. ~e, ~et.* Grua plakë, shtrigë, keqbërëse. (P); **axhúze** (K.) (Ibrahimi 2007:47).

azgán,~e *mb.* (<tur.azgIn) 1. Trim. 2. *fig.* Mendjemadh. P.sh. *Mos u bon azgan i madh.* (Cër.). (Ibrahimi 2007:47).

B

ba: *m.* Rrethi i Matit

ba:c-a *m.* vëllanë më të madh (Shqipërinë Veriore)

bab *m.* gjyshi babai i nënës (Karshiakë)

bab,-i *m* (Tetovë, Prilep)

baba dajës *m.* babai i nënës (Prilep, Dibër)

baba dajxhes *m.* gjyshi babai i nënës (Tetovë)

baba i me:r *m.* babai i mirë

baba i ri *m.* i ati, babai (Karshiakë, Shkup)

baba *m.* Rrethi i Matit

babaplák,u *m.* 1. babai i babës, gjyshi (Prilep, Tetovë–Orashë). 2. stërgjyshi (Prilep) (Ibrahimi 2007:47).

babapqak *m.* gjyshi (Tetovë)

baba,-i *m.* i ati, babai (Prilep, Tetovë)

baball^uók *mb.* Pasuria e patundshme që ka lënë babai. P.sh. *Kiet shpai e kaum baball^uok; Baball^uok e kimi.* (P.,K.).

(Zhit., Cër.)

babaxhýpi *euf.* Babai i nuses. P.sh. “...*Bon konak baba xhypi, bon konak/se do t'vije Jago baba, bon konak*” (Ibrahimi 2003: 80). (Ibrahimi 2007:47).

babi i babit *a.f.* stërgjyshi (Struge toskë)

babo *m.* 1. gjyshi. 2. stërgjyshi (Tetovë)

babúç,-i *m.* Shprehje përkëdhelëse për babanë. P.sh. *Ku osh babuçi tem.* (Cër.); **babúçe** (Zhit.). (Ibrahimi 2007:47).

babúçka *m.* Shprehje përkëdhelëse për babain. P.sh. *Babuçka d'um bleje shiq'era.* (Cër.). (Ibrahimi 2007:48).

babush,-i *m.* 1. gjyshi (Tetovë). 2. stërgjyshi (Struge toskë)

babuçka *m.* gjyshi (Prilep)

bac, -i 1. babë, 2. vëllai i madh. Në të folmen e Petreshticës fëmijët i thonë babës babë, bac (fëmija i parë) dhe agë.

baç,-i *m.* i ati, babai (Karshiakë, Shkup)

bacalok – përdoret për t'iu drejtuar një njeriu më të moshuar në shenjë respekti, bacës, mixhës (Gjakovë).

bacë – vëlla i madh; emërtim për të dashurit dhe të afërmit në shenjë respekti ndaj më të vjetërve; *bacalok, baclok* (Deçan). *bac/ bac/bal* (*Baca Adem, Bali Adem*).

bac-i *m.* vëllanë më të madh (Shqipërinë Veriore)

bajrak dylber aga - emërtimet sinonimike nga nusja, për vëllezërit e burrit (Selmani 2016:105)

bajrak dylber aga *m.* kunatit (Gostivar)

balldësk,-a *f.* motra e gruas (Prilep)

balldëz/e,~ja *f.sh.* ~**et** Motër e gruas. P.sh. *Ajo osht balldëzja teme.* (P.,K.). (Ibrahimi 2007:48).

baxhanak,-u *m.* burri i motrës së gruas (Strugë toskë, Tetovë, Prilep)

bik nene *f.* nusja vjehrrën (Gostivar)

bilazër,~i *m.sh.* ~**ët.** Vëllai, bilazeri i madh. P.sh. *Ne jemi dy bilazera.* (P.); **birazër** (K.). (Ibrahimi 2007:52).

bilazerka *f.* motra e madhe (Prilep)

biro *m.* i biri (Tetovë)

bis nene *f.* nusja vjehrrën (Gostivar)

byrazerka *f.* motra e madhe (Strugë gegë dhe toskë)

C

cauc *f.* e bija (Prilep Tetovë)

cea – xhaxhai, vëllai i babait

coca *f.* e bija (Dibër)

couc *f.* e bija (Strugë gegë)

cuc *f.* e bija (Strugë toskë, Karshiakë)

Ç

çardak qifli qibar mbesa- emërtimet sinonimike nga nusja, për mbesat e burrit (Selmani 2016:106). **P.sh.** *lira në jahat- lira në çardak qifli qibar mbesa me tabiat.*

çeGjuro *tf.* **grua e Gjures** (Arbëneshët e Zarës), (Ibrahimi 2018:13)

çeMates *tf.* **grua e Mates** (Arbëneshët e Zarës), (Ibrahimi 2018:13)

çibare hënmi - emërtimet sinonimike nga nusja, për motrën e burrit (Selmani 2016:105)

çun *m.* i biri (Strugë gegë, toskë)

D

da:xh *f.*- daja (Rrethi i Matit)

dada – vëllai i babait, xhaxhai

dada *f.* motra e madhe (Tetovë, Shqipëria Veriore)

dadaçele *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

dadagjul *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

dadamotër *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

dadaxhark *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

daduçja *f.* motra e madhe (Shqipëria Veriore)

daduq - halla (Gostivar, Tetovë)

daj,-a *f.* 1. vëllai i motrës (Karshiakë); 2. vëllai i nënës (Prilep Tetovë)

dajca - grua e dajës

dajko *m.* vëllai i nënës (Prilep)

dajojca *f.* nusja e dajës (Prilep)

dajovejc *f.* nusja e dajës (Strugë gegë)

